



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 6	2003	Shkurt
--------------	-------------	---------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8992 datë 30.1.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin e Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave”.....	183
Ligj nr. 8993 datë 30.1.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”.....	197
Ligj nr. 8994 datë 30.1.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Italisë për veprimtarinë e bashkëpunimit dhe të asistencës, për ristrukturimin e zonës në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe atë të pistës së fluturimit në Pish-Poro”.....	209
Ligj nr. 8995 datë 30.1.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për privilegjet dhe imunitetet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike”.....	213

L I G J
Nr.8992, datë 30.1.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “PROTOKOLLIN E
MARRËVESHJES SË MADRIDIT PËR REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR TË
MARKAVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Protokollin e Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3683 , datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

PROTOKOLLI
QË I PËRKET MARRËVESHJES SË MADRIDIT NË LIDHJE ME REGJISTRIMIN
NDËRKOMBËTAR TË MARKAVE

Adaptuar në Madrid, më 27 qershor 1989

Neni 1

Anëtarësimi në Bashkimin e Madridit

Shtetet Palë të këtij Protokolli (këtej e tutje quajtur “Shtete Kontraktuese”, edhe kur ato nuk janë Palë të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markave, rishikuar në Stokholm në vitin 1967, dhe ndryshuar në vitin 1979 (këtej e tutje quajtur “Marrëveshja e Madridit, Stokholmit”) dhe organizatat e përmendura në nenin 14(1) (b), të cilat janë Palë të këtij Protokolli (këtej e tutje quajtur “Organizata Kontraktuese”) do të jenë anëtarë të të njëjtit Bashkim të të cilit vendet palë të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) janë anëtare. Çdo referim në këtë Protokoll në “Palët Kontraktuese” interpretohet si një referim për Shtetet Kontraktuese dhe Organizatat Kontraktuese së bashku.

Neni 2

Mbrojtja që sigurohet përmes regjistrimit ndërkombëtar

1. Aty ku një aplikim për regjistrimin e një marke ka qenë depozituar pranë zyrës së një Pale Kontraktuese, ose aty ku një markë ka qenë regjistruar në regjistrin e zyrës së një Pale Kontraktuese, personi, në emër të të cilit ky aplikim (këtej e tutje quajtur “aplikim bazë”) ose ky regjistrim (këtej e tutje quajtur “regjistrim bazë”) qëndron, varësisht dispozitave të këtij Protokolli, mund të sigurojë mbrojtje për markën e tij në territorin e Palëve Kontraktuese, nëpërmjet regjistrimit të markës në Regjistrin e Byrosë Ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (këtej e tutje të

quajtura respektivisht “Regjistrim Ndërkombëtar”, “Regjistër Ndërkombëtar”, “Byro Ndërkombëtare” dhe “Organizatë” me kusht që:

i) aty ku aplikimi bazë ka qenë depozituar, pranë zyrës së një Shteti Kontraktues, ose aty ku regjistrimi bazë është bërë nga një zyrë e tillë, personi, në emër të të cilit aplikimi qëndron, është i një kombësie të Shtetit Kontraktues, ose është banor i përhershëm, ose ka një aktivitet efektiv industrial ose tregtar real në Shtetin Kontraktues të përmendur;

ii) aty ku aplikimi bazë ka qenë depozituar pranë zyrës së një Organizate Kontraktuese, ose aty ku regjistrimi bazë ka qenë bërë pranë një zyre të tillë, personi, në emër të të cilit aplikimi qëndron, është i një kombësie të një Shteti anëtar të kësaj Organizate Kontraktuese, ose është banor i përhershëm, ose ka një aktivitet efektiv industrial ose tregtar real në territorin e Organizatës Kontraktuese të përmendur.

2. Aplikimi për regjistrim ndërkombëtar (këtej e tutje quajtur “aplikim ndërkombëtar”) depozitohet pranë Byrosë Ndërkombëtare përmes ndërmjetësisë së zyrës pranë të cilës është depozituar aplikimi bazë ose nga e cila është bërë regjistrimi bazë (këtej e tutje quajtur “Zyra e Origjinës”) sipas rastit.

3. Çdo referim në këtë Protokoll për një “zyrë” ose një zyrë të Palës Kontraktuese interpretohet si një referim për zyrën përgjegjëse, në emër të një Pale Kontraktuese, për regjistrimin e markave, dhe çdo referim në këtë Protokoll për “markat” interpretohet si një referim për markat tregtare dhe markat e shërbimit.

4. Për qëllime të këtij Protokollit, “territori i një Pale Kontraktuese” do të thotë: aty ku Pala Kontraktuese është një shtet, territori i këtij shteti dhe, aty ku Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare, territori në të cilin zbatohet marrëveshja konstitucionale e kësaj organizate ndërqeveritare.

Neni 3

Aplikimi ndërkombëtar

1. Çdo aplikim ndërkombëtar sipas këtij Protokollit do të jetë paraqitur në formën e përshkruar nga rregulloret. Zyra e Origjinës do të vërtetojë që veçoritë të cilat shfaqen në aplikimin ndërkombëtar korrespondojnë me veçoritë që shfaqen në kohën e vërtetimit, në aplikimin bazë ose regjistrimin bazë, sipas rastit. Përveç kësaj, Zyra e përmendur do të tregojë:

i) në rastin e aplikimit bazë, datën dhe numrin e aplikimit;

ii) në rastin e regjistrimit bazë, datën dhe numrin e regjistrimit, si dhe datën dhe numrin e aplikimit nga të cilët rezultonte aplikimi bazë.

Zyra e origjinës do të tregojë, gjithashtu, datën e aplikimit ndërkombëtar.

2. Aplikimi duhet të tregojë mallrat dhe shërbimet, në lidhje me të cilat pretendohet mbrojtja dhe gjithashtu, në qoftë se është e mundur, klasën ose klasat korresponduese sipas klasifikimit, vendosur nga Marrëveshja e Nicës, në lidhje me klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të regjistrimit të markave. Në qoftë se aplikanti nuk jep të tillë tregues, Byroja Ndërkombëtare do të klasifikojë mallrat dhe shërbimet në klasat e përshatshme të klasifikimit të përmendur. Tregimi i klasave, dhënë nga aplikanti, do të jetë objekt kontrolli i Byrosë Ndërkombëtare, e cila do të ushtrojë kontrollin e përmendur shoqëruar dhe nga Zyra e Origjinës. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Zyrës së përmendur dhe Byrosë Ndërkombëtare do të mbizotërojë opinionin e kësaj të fundit.

3. Në qoftë se aplikanti pretendon për ngjyrën, si një veçori dalluese e markës së tij, atij do t’i kërkohet:

i) Të theksojë faktin, dhe do të depozitojë me aplikimin e tij ndërkombëtar një njoftim që specifikon ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të pretenduara.

ii) T’i shtojë aplikimit të tij ndërkombëtar kopje me ngjyrë të markës së përmendur, e cila i bashkëngjitet njoftimit të dhënë nga Byroja Ndërkombëtare; numri i këtyre kopjeve do të përcaktohet nga rregulloret.

4. Byroja Ndërkombëtare do të regjistrojë menjëherë markat e depozituara sipas nenit 2. Regjistrimi ndërkombëtar do të mbajë datën në të cilën është marrë aplikimi ndërkombëtar në Zyrën e Origjinës, me kusht që aplikimi ndërkombëtar të jetë marrë nga Byroja Ndërkombëtare brenda një periudhe prej dy javësh nga kjo datë. Në qoftë se aplikimi ndërkombëtar nuk është marrë brenda kësaj

periudhe, regjistrimi ndërkombëtar do të mbajë datën në të cilën aplikimi ndërkombëtar i përmendur është marrë nga Byroja Ndërkombëtare. Byroja Ndërkombëtare do t'i njoftojë pa vonesë regjistrimin ndërkombëtar zyrës përkatëse. Markat e regjistruara në Regjistrin Ndërkombëtar publikohen në një gazetë periodike, nxjerrë nga Byroja Ndërkombëtare, bazuar në hollësitë që përmban aplikimi ndërkombëtar.

5. Me qëllim publikimin e markave të regjistruara në Regjistrin Ndërkombëtar, çdo zyrë do të marrë nga Byroja Ndërkombëtare falas një numër kopjesh të gazetës së përmendur dhe një numër kopjesh me çmim të ulur, sipas kushteve të vendosura nga Asambleja përmendur në nenin 10 (këtej e tutje quajtur "Asamble"). Ky publikim gjykohet të jetë i mjaftueshëm për interesat e të gjitha Palëve Kontraktuese dhe mund të mos kërkohet asnjë publikim tjetër nga mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 3bis

Efektet territoriale

Mbrojtja që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar do të shtrihet tek çdo Palë Kontraktuese vetëm me kërkesë të personit, i cili depoziton aplikimin ndërkombëtar ose i cili është mbajtës i regjistrimit ndërkombëtar. Sidoqoftë nuk mund të bëhet asnjë kërkesë e tillë përsa i përket Palës Kontraktuese, zyra e së cilës është Zyra e Origjinës.

Neni 3ter

Kërkesa për "shtrirje territoriale"

1. Çdo kërkesë për shtrirje territoriale të mbrojtjes që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar, të çdo Pale Kontraktuese, do të jetë përmendur në mënyrë të veçantë në aplikimin ndërkombëtar.

2. Një kërkesë për shtrirje territoriale mund të jetë bërë më vonë në regjistrimin ndërkombëtar. Çdo kërkesë e tillë paraqitet në formën e përshkruar nga rregulloret. Kjo regjistrohet menjëherë nga Byroja Ndërkombëtare, e cila do t'i njoftojë, pa vonesë, këtë shënim zyrës ose zyrave të interesuara. Ky regjistrim publikohet në gazetën periodike të Byrosë Ndërkombëtare. Kjo shtrirje territoriale zbatohet nga data në të cilën u regjistrua në Regjistrin Ndërkombëtar; vlefshmëria e kësaj shtrirjeje, zgjat deri në mbarimin e afatit të regjistrimit ndërkombëtar me të cilën është e lidhur.

Neni 4

Efektet e regjistrimit ndërkombëtar

1. a) Nga data e regjistrimit ose zbatimit të shërbimeve sipas dispozitave të nenit 3 dhe 3ter mbrojtja e markës, në çdo vend Palë Kontraktuese të interesuar, do të jetë e njëjtë sikur marka të jetë depozituar direkt pranë zyrës së Palës Kontraktuese. Në qoftë se nuk është shënuar refuzim në Byronë Ndërkombëtare sipas neni 5 (1) dhe (2), ose në qoftë se refuzimi i shënuar sipas neni të përmendur ka qenë tërhequr nga paraqitësi më pas, mbrojtja e markës në Palën Kontraktuese të interesuar do të jetë e njëjtë sikur marka ka qenë regjistruar nga zyra e kësaj Pale Kontraktuese.

b) Përcaktimi i klasave të mallrave dhe shërbimeve, kërkuar në nenin (3), nuk do të detyrojë Palët Kontraktuese lidhur me përcaktimin e qëllimit të mbrojtjes së markës.

2. Çdo regjistrim ndërkombëtar do të gëzojë të drejtën e prioritetit, parashikuar nga neni (4) i Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, pa qenë e nevojshme që të zbatohet formalitetet e përshkruara në seksionin D të këtij neni.

Neni 4bis

Zëvendësimi i një regjistrimi kombëtar ose rajonal nga një regjistrim ndërkombëtar

1. Aty ku një markë, e cila është subjekt i regjistrimit kombëtar ose rajonal në zyrën e një Pale Kontraktuese, është gjithashtu subjekt i një regjistrimi ndërkombëtar dhe, të dy regjistrimet së bashku qëndrojnë në emër të të njëjtit person, regjistrimi ndërkombëtar gjykohet të zëvendësojë regjistrimin kombëtar apo rajonal, pa cenuar ndonjë të drejtë të fituar në sajë të këtyre të fundit, me kusht që:

i) mbrojtja, që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar, të shtrihet në Palën Kontraktuese të

përmendur sipas nenit 3ter (1) ose (2);

ii) të gjitha mallrat dhe shërbimet listuar në regjistrimin kombëtar ose rajonal janë të listuara gjithashtu në regjistrimin ndërkombëtar përsa i përket Palës Kontraktuese të përmendur;

iii) kjo shtrirje do të ketë efekt pas datës së regjistrimit kombëtar ose rajonal.

2. Zyrës së përmendur në paragrafin (1), me anë të një kërkesë, i kërkohet të mbajë shënim për regjistrimin ndërkombëtar në regjistrin e saj.

Neni 5

Refuzimi dhe pavlefshmëria e efekteve të regjistrimit ndërkombëtar përsa u përket Palëve të interesuara Kontraktuese

1. Aty ku legjislacioni në fuqi autorizon, çdo zyrë e një Pale Kontraktuese, e cila ka qënë njoftuar nga Byroja Ndërkombëtare për një shtrirje në këtë Palë Kontraktuese, sipas nenit 3ter (1) ose (2) të mbrojtjes, që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar do të ketë të drejtën të deklarojë, në një njoftim të refuzimit se mbrojtja nuk i është dhënë markës e cila është subjekt i kësaj shtrirjeje në Palën Kontraktuese të përmendur. Çdo refuzim i tillë mund të jetë i bazuar vetëm në arsyet të cilat do të zbatoheshin sipas Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, për rastin e një marke depozituar direkt pranë zyrës e cila njofton refuzimin. Megjithatë, mbrojtja nuk mund të refuzohet, qoftë edhe pjesërisht, nga shkak i vetëm se legjislacioni në fuqi lejon regjistrimin vetëm në një numër të kufizuar klasash ose për një numër të kufizuar mallrash dhe shërbimesh.

2.a) Çdo zyrë që dëshiron të ushtrojë këtë të drejtë do të njoftojë refuzimin e saj në Byronë Ndërkombëtare, së bashku me një deklaratë me të gjitha arsyet, brenda periudhës së përshkruar nga ligji i zbatueshëm për këtë zyrë dhe së fundi, varësisht nënparagrafëve (b) dhe (c), përpara përfundimit të një viti nga data në të cilën njoftimi i shtrirjes, përmendur në paragrafin (1) i ka qënë dërguar kësaj zyre nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Pavarësisht nënparagrafit (a), çdo Palë Kontraktuese mund të deklarojë që, për regjistrimin ndërkombëtar bërë sipas këtij Protokolli, afati kohor prej një viti, përmendur në nënparagrafin (a) është zëvendësuar nga 18 muaj.

c) Kjo deklaratë mund të specifikojë gjithashtu, kur një refuzim për mbrojtje mund të rezultojë nga një kundërshtim ndaj dhënies e mbrojtjes, ky refuzim mund t'i njoftohet, nga Zyra e Palës Kontraktuese të përmendur, Byrosë Ndërkombëtare pas përfundimit të kohës limit prej 18 muajsh, por vetëm në qoftë se:

i) Kjo ka informuar, përpara kohës limit të përfundimit prej 18 muajsh, Byronë Ndërkombëtare për mundësinë që këto kundërshtime mund të depozitohen pas përfundimit të kohës së limit prej 18 muajsh.

ii) Njoftimi i këtij refuzimi, bazuar në një kundërshtim, është bërë brenda kohës limit jo më shumë se shtatë muaj nga data në të cilët afati i kundërshtimit në qoftë se afati i kundërshtimit përfundon përpara kësaj kohe limit të shtatë muajve, njoftimi duhet të jetë bërë brenda një kohe limit prej një muaji nga përfundimi i afatit të kundërshtimit.

d) Çdo deklaratë sipas nënparagrafit (b) ose (c), që mund të bëhet sipas instrumenteve përmendur në nenin 14 (2), dhe data efektive e deklaratës do të jetë e njëjtë me datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli përsa i përket shtetit ose organizatës ndërkombëtare që ka bërë deklaratën. Çdo deklaratë e tillë mund të bëhet gjithashtu me vonë, dhe në këtë rast deklarata do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së saj nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës (këtej e tutje “Drejtori i Përgjithshëm”), ose në çdo datë të mëvonshme shënuar në deklaratë, përsa i përket çdo regjistrimi ndërkombëtar, data e të cilit është e njëjtë ose e mëvonshme se data efektive e deklaratës.

e) Me përfundimin e afatit prej 10 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli, Asambleja do të kontrollojë punën e sistemit në përputhje me nënparagrafët (a) dhe (d). Gjithashtu dispozitat e nënparagrafit të përmendur mund të modifikohen me një vendim unanim të Asamblesë.

3. Byroja Ndërkombëtare do t'i përcjellë, pa vonesë, mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar një kopje të njoftimit të refuzimit. Mbajtësi i përmendur do të ketë të njëjtat trajtime, sikur marka të ketë qënë depozituar prej tij direkt pranë zyrës, e cila ka njoftuar refuzimin e saj. Kur Byroja Ndërkombëtare ka marrë informacion sipas paragrafit (2)(c)(1), do t'ia përcjellë informacionin, pa vonesë, mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar.

4. Arsyet për refuzimin e markës do t'i jenë komunikuar nga Byroja Ndërkombëtare, çdo pale

të interesuar e cila mund ta kërkojë.

5. Çdo zyrë e cila nuk ka njoftuar, përsa i përket një regjistrimi të dhënë, çdo refuzim të përkohshëm apo përfundimtar Byronë Ndërkombëtare sipas paragrafëve (1) dhe (2) do të humbë përfitimin e të drejtës së siguruar në paragrafin (1).

6. Pavlefshmëria, nga autoritetet kompetente të një Pale Kontraktuese, e efekteve, në territorin e kësaj Pale Kontraktuese të një regjistrimi ndërkombëtar, nuk mund të shprehet pa i dhënë kohë dhe mundësi mbajtësit të këtij regjistrimi ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të tij. Pavlefshmëria i njoftohet Byrosë Ndërkombëtare.

Neni 5bis

Dëshmia e dokumentuar e ligjshmërisë së përdorimit të elementeve të caktuar të markës

Dëshmia e dokumentuar e ligjshmërisë së përdorimit të elementeve të caktuara të përfshira në një markë, të tilla si emblema dhe parzmore, ata heraldike, portrete, titujt nderi, tituj, emra tregtarë, emra të personave të ndryshëm nga emri i aplikantit ose të tjera si mbishkrime, të cilat mund të jenë kërkuar nga zyrat e Palëve Kontraktuese, do të jetë e përjashtuar nga çdo legalizim ashtu siç dhe nga çdo vërtetim, përveç asaj të Zyrës së Origjinës.

Neni 5ter

Kopjet e regjistrimit në Regjistrin Ndërkombëtar; kërkimet për parashikime; ekstraktet nga Regjistri Ndërkombëtar

1. Byroja Ndërkombëtare do t'i lëshojë çdo personi që aplikon, kundrejt pagesës së një tarife të vendosur nga rregulloret, një kopje të regjistrimit në Regjistrin Ndërkombëtar që i përket një marke të veçantë.

2. Byroja Ndërkombëtare, gjithashtu kundrejt pagesës, mund të ndërmarrë kërkime për regjistrim të mëparshëm ndërmjet markave, të cilat janë subjekte të regjistrimeve ndërkombëtare.

3. Ekstraktet nga Regjistri Ndërkombëtar, kërkuar me qëllim prodhimin e tyre në një prej Palëve Kontraktuese, do të jenë të përjashtuara nga çdo lloj legalizimi.

Neni 6

Periudha e vlefshmërisë e regjistrimit ndërkombëtar; varësia dhe pavarësia e regjistrimit ndërkombëtar

1. Regjistrimi i një marke në Byronë Ndërkombëtare është i efektshëm për dhjetë vjet, me mundësinë e rinovimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 7.

2. Në përfundim të një periudhe prej pesë vjetësh, nga data e regjistrimit ndërkombëtar, ky regjistrim do të bëhet i pavarur nga aplikimi bazë ose regjistrimi që rezulton, ose regjistrimi bazë, siç mund të jetë rasti, varësisht dispozitave të mëposhtme.

3. Mbrojtja, që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar, në çdo rast ka qenë subjekt i një transferimi, ndoshta jo të kërkuar për shumë kohë në qoftë se, përpara përfundimit të pesë vjetëve nga data e regjistrimit ndërkombëtar, aplikimi bazë ose regjistrimi që rezulton prej tij, siç mund të jetë rasti, ka qenë tërhequr, i ka kaluar afati, ka qenë i braktisur ose ka qenë subjekt i një vendimi final për refuzim, revokim, anulim ose pavlefshmëri në lidhje me të gjitha ose disa mallra apo shërbime të listuara në regjistrimin ndërkombëtar. E njëjta gjë zbatohet në qoftë se:

- i) një apelim kundër vendimit që refuzon efektet e aplikimit bazë;
- ii) një veprim që kërkon tërheqjen e aplikimit bazë ose revokimin, anulimin apo pavlefshmërinë e regjistrimit, që rezulton nga aplikimi bazë, ose regjistrimi bazë; ose
- iii) një kundërshtim për aplikimin bazë

rezulton, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare, në një vendim final të refuzimit, revokimit, anulimit ose pavlefshmërisë, ose që urdhëron tërheqjen e aplikimit bazë, ose regjistrimit që rezulton prej tij, ose regjistrimit bazë, siç mund të jetë rasti, me kusht që ky apelim, veprim ose kundërshtim të ketë filluar përpara përfundimit të periudhës së përmendur. E njëjta gjë zbatohet gjithashtu, në qoftë se aplikimi bazë është tërhequr, ose regjistrimi që rezulton nga aplikimi bazë është braktisur, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare, me kusht që, në kohën e tërheqjes ose braktisjes, aplikimi ose

regjistrimi i përmendur ishte subjekt i një rasti përmendur në nënparagrafin (i), (ii) ose (iii) dhe që këto raste të kenë filluar përpara përfundimit të periudhës së përmendur.

4. Zyra e Origjinës do të njoftojë, siç përshkruhet në rregulloret, Byronë Ndërkombëtare për faktet dhe vendimet përkatëse sipas paragrafit (3) dhe Byroja Ndërkombëtare do të njoftojë, siç përshkruhet në rregulloret, palët e interesuara dhe do të kryejë çdo publikim për këtë arsye. Zyra e Origjinës do t'i kërkojë, aty ku është e zbatueshme, Byrosë Ndërkombëtare të anulojë zgjatjen e aplikueshme, regjistrimit ndërkombëtar, dhe Byroja Ndërkombëtare do të vazhdojë sipas procedurave.

Neni 7

Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar

1. Çdo regjistrim ndërkombëtar mund të jetë rinovuar për një periudhë prej dhjetë vjetësh nga përfundimi i periudhës pararendëse, me pagesë të thjeshtë të tarifës bazë dhe, varësisht nenit 8 (7), të tarifave plotësuese dhe shtesës kërkuar në nenin 8(2).

2. Rinovimi nuk mund të sjellë ndonjë ndryshim në regjistrimin ndërkombëtar në formularin e tij të fundit.

3. Gjashtë muaj përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, Byroja Ndërkombëtare do t'i kujtojë, me anë të një njoftimi jozyrtar, mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar dhe përfaqësuesit të tij, në qoftë se ka, datën e saktë të përfundimit.

4. Varësisht një pagese shtesë caktuar nga rregulloret, një periudhë favori prej gjashtë muajsh do të jetë e lejuar për rinovimin e regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 8

Tarifat për aplikimin dhe regjistrimin ndërkombëtar

1. Zyra e Origjinës mund të caktojë, siç e gjykon ajo të arsyshme, dhe të mbledhë në përfitim të saj, një tarifë e cila mund t'i kërkohej aplikantit për regjistrim ndërkombëtar ose mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me depozitimin e aplikimit ndërkombëtar ose rinovimin e regjistrimit ndërkombëtar.

2. Regjistrimi i një marke në Byronë Ndërkombëtare do të jetë subjekt i parapagesës së një tarife ndërkombëtare e cila, varësisht dispozitave të paragrafit (7)(a) do të përfshijë:

i) një tarifë bazë;

ii) një tarifë shtesë për çdo klasë të klasifikimit ndërkombëtar, përtej tre, në të cilën do të jenë mallrat ose shërbimet për të cilat marka është aplikuar;

iii) një tarifë plotësuese për çdo kërkesë për shtrirjen e mbrojtjes sipas nenit 3ter.

3. Megjithatë, tarifa shtesë, specifikuar në paragrafin (2)(iii), pa gjykuar mbi datën e regjistrimit ndërkombëtar, duhet të jetë paguar brenda periudhës së fiksuar në rregulloret, në qoftë se numri i klasave të mallrave dhe shërbimeve ka qenë fiksuar ose kundërshtuar nga Byroja Ndërkombëtare. Në qoftë se, me përfundimin e periudhës së përmendur, tarifat shtesë nuk janë paguar ose lista e mallrave, ose shërbimeve nuk është zvogëluar në shtrirjen e kërkuar nga aplikanti, aplikimi ndërkombëtar gjykohet të jetë i abandonuar.

4. Produkti vjetor i faturave të ndryshme nga regjistrimet ndërkombëtare, me përjashtim të faturave të përfituara nga tarifat e përmendura në paragrafët (2)(ii) dhe (iii) ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve Kontraktuese nga Byroja Ndërkombëtare, pas zbritjes së shpenzimeve dhe pagesave të nevojshme të kërkuara për zbatimin e këtij Protokolli.

5. Sasitë e përfituara nga pagesat shtesë kërkuar në paragrafin (2)(iii), me përfundimin e çdo viti, ndahen ndërmjet Palëve Kontraktuese të interesuara në raport me numrin e markave, për të cilat është aplikuar mbrojtja gjatë atij viti, ky numër shumëzohet, në rastin e Palëve Kontraktuese, të cilat bëjnë një shqyrtim, me një koeficient që përcaktohet nga rregulloret.

6. Sasitë e përfituara nga tarifat plotësuese të kërkuara në paragrafin (2)(iii) ndahen sipas të njëjtave rregulla si ato të kërkuara në paragrafin (5).

7. a) Çdo Palë Kontraktuese, në lidhje me çdo regjistrim ndërkombëtar në të cilin është përmendur sipas nenit 3ter, dhe në lidhje me rinovimin e çdo regjistrimi ndërkombëtar të tillë, mund të deklarojë që ajo dëshiron të marrë, në vend të ndarjes së të ardhurave që vijnë nga tarifat plotësuese dhe tarifat shtesë, një tarifë (këtej e tutje e quajtur “tarifë individuale” masa e së cilës tregohet në

deklarimin dhe mund të jetë e ndryshueshme në deklarimet e tjera, por nuk mund të jetë më e madhe se ekuivalenti i masës të cilën zyra e Palës Kontraktuese të përmendur do të ketë të drejtën për ta marrë nga një aplikant për një regjistrim dhjetëvjeçar, ose nga mbajtësi i një regjistrimi për një rinovim dhjetëvjeçar të këtij regjistrimi të një marke në regjistrin e zyrës së përmendur masa e përmendur duke qenë e zvogëluar nga kursimet që rezultojnë nga procedurat ndërkombëtare. Aty ku kjo tarifë individuale është e pagueshme:

i) asnjë tarifë shtesë përmendur në paragrafin (2)(iii) nuk do të jetë e pagueshme vetëm në qoftë se Palët Kontraktuese, të cilat kanë bërë një deklarim sipas këtij nënparagrafi, janë përmendur në nenin 3ter; dhe

ii) asnjë tarifë plotësuese përmendur në paragrafin (2)(iii) nuk do të jetë e pagueshme përse i përket çdo Palë Kontraktuese, e cila ka bërë një deklarim sipas këtij nënparagrafi.

b) Çdo deklarim sipas nënparagrafit (a) mund të jetë bërë në instrumentet e përmendura në nenin 14 (2) dhe data efektive e deklarimit do të jetë e njëjtë me datën e hyrjes në fuqi të këtij protokollit, përse i përket shtetit ose organizatës ndërqeveritare që ka bërë deklarimin. Çdo deklarim i tillë mund të jetë bërë gjithashtu më vonë, në këtë rast deklarimi do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së tij nga Drejtori i Përgjithshëm, ose në një datë të mëvonshme shënuar në deklarim, përse i përket çdo regjistrimi ndërkombëtar data e të cilit është e njëjtë ose më e vonshme, se data efektive e deklarimit.

Neni 9

Shënimi i ndryshimeve në të drejtën e pronësisë së një regjistrimi ndërkombëtar

Me kërkesë të personit në emër të të cilit qëndron regjistrimi ndërkombëtar, ose me kërkesë të një zyre të interesuar bërë ex officio, ose me kërkesë të një personi të interesuar, Byroja Ndërkombëtare do të shënojë në Regjistrin Ndërkombëtar çdo ndryshim në të drejtën e pronësisë së këtij regjistrimi, në lidhje me të gjitha ose disa Palë Kontraktuese në territoret e të cilave regjistrimi i përmendur ka efekt dhe përse u përket të gjitha ose disa mallrave, ose shërbimeve listuar në regjister, me kusht që mbajtësi i ri është një person i cili, sipas nenit 2(1), ka të drejtën të depozitojë aplikime ndërkombëtare.

Neni 9bis

Shënimi i çështjeve të caktuara në lidhje me një regjistrim ndërkombëtar

Byroja Ndërkombëtare do të shënojë në Regjistrin Ndërkombëtar:

- i) çdo ndryshim në emër ose adresë të mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar;
- ii) caktimin e një përfaqësuesi të mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar dhe çdo fakt tjetër përkatës që ka lidhje me përfaqësuesin;
- iii) çdo kufizim, në lidhje me të gjitha ose disa nga Palët Kontraktuese, të mallrave dhe shërbimeve listuar në Regjistrin Ndërkombëtar;
- iv) çdo kundërshtim, anulim ose pavlefshmëri të regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me të gjitha ose disa nga Palët Kontraktuese;
- v) çdo fakt tjetër përkatës, identifikuar në rregulloret, në lidhje me të drejtat për një markë, që është subjekt i një regjistrimi ndërkombëtar.

Neni 9ter

Tarifë për shënime të caktuara

Çdo shënim sipas nenit 9 ose sipas nenit 9bis mund të jetë subjekt i pagesës së një tarife.

Neni 9quater

Zyra e përbashkët e disa shteteve kontraktuese

1. Në qoftë se disa Shtete Kontraktuese bien dakord që të zbatojnë unifikimin e legjislacionit të tyre të brendshëm për markat, ata mund të njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm:

- i) që një zyrë e përbashkët do të jetë zëvendësuese për Zyrën Kombëtare të secilit prej tyre;

dhe

ii) që të gjitha territoret e tyre respektive do të jenë gjykuar që të jenë një shtet i vetëm për qëllimet e aplikimit të të gjithë ose pjesë të dispozitave të mëparshme të këtij neni, si dhe dispozitave të neneve 9quinquies dhe 9sexies .

2. Ky njoftim nuk do të ketë efekt deri tre muaj pas datës së komunikimit të tij Palëve të tjera Kontraktuese nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 9quinquies

Transformimi i një regjistrimi ndërkombëtar në aplikime kombëtare dhe rajonale

Aty ku, në rast se regjistrimi ndërkombëtar është anuluar, me kërkesë të Zyrës së Origjinës, sipas nenit 6 (4), përsa u përket të gjitha ose disa mallrave dhe shërbimeve listuar në regjistrin e përmendur, personi, i cili është mbajtës i regjistrimit ndërkombëtar, depoziton një aplikim për regjistrimin e të njëjtës markë pranë zyrës të çdo Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës regjistrimi ndërkombëtar ka efekt, që aplikimi do të jetë trajtuar sikur ai të jetë depozituar në datën e regjistrimit ndërkombëtar, sipas nenit 3 (4) ose në datën e shënimit të shtrirjes territoriale, sipas nenit 3ter (2) dhe, në qoftë se regjistrimi ndërkombëtar gëzon prioritet, do të gëzojë të njëjtin prioritet, me kusht që:

i) ky aplikim është plotësuar brenda tre muajve nga data në të cilën u anulua regjistrimi ndërkombëtar;

ii) mallrat dhe shërbimet e listuara në aplikim janë të mbuluara në fakt nga lista e mallrave dhe shërbimeve, që përmban regjistrimi ndërkombëtar përsa i përket Palës Kontraktuese të interesuar;

iii) ky aplikim është në pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit në fuqi, duke përfshirë kërkesat në lidhje me tarifën.

Neni 9sexies

Mbrojtja e Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit)

1. Aty ku, përsa i përket një aplikimi ndërkombëtar të dhënë ose një regjistrimi ndërkombëtar të dhënë, Zyra e Origjinës është zyrë e një shteti që është Palë e këtij Protokolli dhe e Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) njëkohësisht, dispozitat e këtij Protokolli nuk do të kenë efekt në territorin e çdo shteti tjetër që është gjithashtu Palë në këtë Protokoll dhe në Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit) njëkohësisht.

2. Asambleja, me një shumicë prej tre të katërtat, mund të shfuqizojë paragrafin (1) ose kufizojë hapësirën e paragrafit (1), pas përfundimit të periudhës prej dhjetë vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, por jo përpara përfundimit të një periudhe prej pesë vjetësh, nga data në të cilën shumica e vendeve Palë të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) i janë bërë Palë këtij Protokolli. Për votim në Asamble, do të kenë të drejtë të marrin pjesë vetëm ato shtete të cilat janë Palë në të dyja së bashku, si në Marrëveshjen e përmendur dhe në Protokoll.

Neni 10

Asambleja

1. a) Palët Kontraktuese do të jenë anëtare të të njëjtës Asamble si vendet Palë për Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit).

b) Secila Palë Kontraktuese do të përfaqësohet në këtë Asamble me nga një delegat, i cili mund të jetë i asistuar nga delegatë alternativë, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e secilit delegacion do të mbulohen nga Pala Kontraktuese, e cila ka caktuar atë, përveç shpenzimeve të udhëtimit dhe dietës për një delegat të çdo Pale Kontraktuese, të cilat do të paguheshin nga fondet e Bashkimit.

2. Asambleja, me një shumicë prej tre të katërtat, mund të shfuqizojë paragrafin (1) ose të kufizojë hapësirën e paragrafit (1), pas përfundimit të periudhës dhjetëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, por jo përpara përfundimit të një periudhe prej pesë vjetësh, nga data në të cilën shumica e vendeve Palë të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit) i janë bërë Palë këtij Protokolli. Për votim në Asamble do të kenë të drejtë të marrin pjesë vetëm ato shtete të cilat janë Palë në të dyja së bashku, si në Marrëveshjen e përmendur dhe në Protokoll.

Neni 10
Asambleja

1. a) Palët Kontraktuese do të jenë anëtare të të njëjtës Asamble si vendet Palë për Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit).

b) Secila Palë Kontraktuese do të përfaqësohet në këtë Asamble me nga një delegat, i cili mund të jetë i asistuar nga delegatë të ndryshëm, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e secilit delegacion do të mbulohen nga Pala Kontraktuese, e cila e ka caktuar atë, përveç shpenzimeve të udhëtimit dhe dietës për një delegat të çdo Pale Kontraktuese, të cilat do të paguhen nga fondet e Bashkimit.

2. Asambleja, përveç funksioneve të cilat i ka sipas Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), gjithashtu:

i) do të merret me të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin e këtij Protokoll;

ii) do të japë direktiva për Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit të këtij Protokoll, duke marrë në konsideratë çdo koment bërë nga ata vende të Bashkimit, të cilat nuk janë Palë në këtë Protokoll;

iii) do të adaptojë dhe modifikojë dispozitat e rregullores në lidhje me zbatimin e këtij Protokoll;

iv) do të kryejë funksione të tjera të tilla që i përkasin në bazë të këtij Protokoll.

3. a) Secila Palë Kontraktuese do të ketë një votë në Asamble. Për çështjet që u përkasin vetëm vendeve që janë Palë të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), Palët Kontraktuese, që nuk janë Palë të Marrëveshjes së përmendur, nuk do të kenë të drejtë vote, ndërsa për çështjet që u përkasin vetëm Palëve Kontraktuese vetëm këta të fundit do të kenë të drejtë vote.

b) Gjysma e anëtarëve të Asamblesë, të cilët kanë të drejtë vote për një çështje të dhënë, do të përbëjnë një kuorum për qëllime votimi për këtë çështje.

c) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit (b), në qoftë se në çdo sesion, numri i anëtarëve të Asamblesë, që kanë të drejtë vote për një çështje të dhënë të paraqitur është më e vogël se gjysma, por e barabartë ose më e madhe se një e treta e anëtarëve të Asamblesë, që kanë të drejtë vote për këtë çështje, Asambleja mund të marrë vendime, me përjashtim të vendimeve që i përkasin procedurave të saj, por të gjitha këto vendime do të kenë efektivitet, në qoftë se plotësohen kushtet e vendosura këtej e tutje. Byroja Ndërkombëtare do t'u komunikojë vendimet e përmendura anëtarëve të Asamblesë që kanë të drejtë vote për çështjet e përmendura të cilat nuk janë paraqitur dhe do t'i ftojë ata të shprehin me shkrim votën e tyre apo abstenimin brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Në qoftë se, në përfundim të kësaj periudhe, numri i këtyre anëtarëve që kanë shprehur votën e tyre apo abstenimin në këtë mënyrë arrin numrin e anëtarëve të munguar për arritjen e kuorumit në atë sesion, këto vendime do të kenë efekt me kusht që në të njëjtën kohë arrihet shumica e kërkuar.

d) Varësisht dispozitave të nenit 5 (2) (e)9sexies (2), 12 dhe 13 (2), vendimet e Asamblesë do të kërkonin dy të tretat e votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk do të jenë konsideruar si vota.

f) Një delegat mund të paraqesë dhe të votojë vetëm në emër të një anëtari të Asamblesë.

4. Përveç mbledhjeve në sesione të zakonshme dhe sesione të jashtëzakonshme, siç kërkohet nga Marrëveshja e Madridit (Stokholmit), Asambleja do të mbledhet në sesione të jashtëzakonshme me thirrje të Drejtorit të Përgjithshëm, në bazë të kërkesës së një të katërtave të anëtarëve të Asamblesë, që kanë të drejtë vote për çështjet e propozuara për t'u përfshirë në axhendën e sesionit. Axhenda e këtyre sesioneve të jashtëzakonshme do të jetë përgatitur nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 11
Byroja Ndërkombëtare

1. Regjistrimi ndërkombëtar dhe detyrat lidhur me të, si dhe të gjitha detyrat e tjera administrative, sipas ose që kanë të bëjnë me këtë Protokoll, kryhen nga Byroja Ndërkombëtar.

2. a) Byroja Ndërkombëtare, sipas direktivave të Asamblesë, do të bëjë përgatitjet për konferencat e rishikimit të këtij Protokoll.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ato ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për të tilla konferenca rishikimi.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet në këto konferenca rishikimi.

3. Byroja Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër paracaktuar për të në lidhje me këtë Protokoll.

Neni 12 **Financat**

Përsa Palët Kontraktuese janë të interesuara, financat e Bashkimit do të jenë rregulluar nga të njëjtat dispozita të përmbajtura në nenin 12 të Marrëveshjes së Madridit (Stokholmit), me kusht që çdo referim në nenin 8 të Marrëveshjes së përmendur gjykohet të jetë një referim në nenin 8 të këtij Protokollit. Përveç kësaj, për qëllime të nenit 12 (6)(b) të Marrëveshjes së përmendur, Organizatat Kontraktuese, varësisht një vendimi unanim përkundrazi nga Asambleja, do të jenë të konsideruar t'i përkasin klasës 1(një) të kontributit sipas Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Neni 13 **Ndryshimi i neneve të caktuara të Protokollit**

1. Propozimet për ndryshimin e neneve 10, 11, 12 dhe këtij neni, mund të ndërmerren nga çdo Palë Kontraktuese ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Të tilla propozime u komunikohen nga Drejtori i Përgjithshëm, Palëve Kontraktuese së paku gjashtë muaj përpara marrjes së tyre në shqyrtim nga Asambleja.

2. Ndryshimet e neneve të përmendur në paragrafin (1) miratohen nga Asambleja. Miratimi do të kërkojë tre të katërtat e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 10 dhe këtij paragrafi, do të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura.

3. Çdo ndryshim i neneve, përmendur në paragrafin (1), do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimit me shkrim të pranimit, kryer sipas proceseve kushtetuese respektive, të marra nga Drejtori i Përgjithshëm nga tre të katërtat e atyre shteteve dhe organizatave ndërqeveritare të cilët, në kohën që u miratua ndryshimi, ishin anëtarë të Asamblesë dhe kishin të drejtë vote për ndryshim. Çdo ndryshim i neneve të përmendura rrjedhimisht të pranuar, do të detyrojë të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare, të cilët janë Palë Kontraktuese në kohën që ndryshimi hyn në fuqi ose bëhen Palë Kontraktuese në një datë të mëvonshme.

Neni 14 **Bërja Palë në Protokoll Hyrja në fuqi**

1. a) Çdo Shtet që është Palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale mund të bëhet Palë në këtë Protokoll.

b) Përveç kësaj, çdo organizatë ndërqeveritare gjithashtu mund të bëhet Palë në këtë Protokoll aty ku plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) së paku një nga shtetet anëtare të kësaj organizate është Palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale;

ii) që Organizata ka një zyrë rajonale me qëllim regjistrimin e markave me efekt në territorin e organizatës, me kusht që kjo zyrë nuk është subjekt i një njoftimi sipas nenit 9quater.

2. Çdo shtet ose organizatë, përmendur në paragrafin (1), mund ta nënshkruajë këtë Protokoll. Çdo shtet ose organizatë, në qoftë se e ka nënshkruar këtë Protokoll, mund të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi të këtij Protokollit ose, në qoftë se nuk e ka nënshkruar këtë protokoll, mund të depozitojë një instrument hyrjeje të këtij Protokollit.

3. Instrumentet e përmendura në paragrafin (2) depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

4. a) Ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj, pasi të jetë depozituar instrumenti i katërt i ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit, me kusht që, së paku, një nga ato instrumente të jetë depozituar nga një vend Palë në Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit) dhe, së paku, një tjetër

instrument nga ata të jetë depozituar nga një shtet jo Palë në Marrëveshjen e Madridit (Stokholmit) ose nga çdo organizatë përmendur në paragrafin (1)(b).

b) Përsa i përket çdo shteti ose organizate tjetër, përmendur në paragrafin (1), ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën është njoftuar nga Drejtori i Përgjithshëm ratifikimi, pranimit, aprovimi ose pëlqimi i tij.

5. Çdo shtet ose organizate, përmendur në paragrafin (1), gjatë depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit të këtij Protokolli, mund të deklarojnë se mbrojtja që rezulton nga çdo regjistrim ndërkombëtar, kryer sipas këtij Protokolli përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, përsa i përket këtij Protokolli, nuk mund të ketë shtrirje tek ai Shtet ose ajo organizatë.

Neni 15 **Denoncimi**

1. Ky Protokoll do të mbetet në fuqi pa kufizim në kohë.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Protokoll me një njoftim adresuar Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Denoncimi do të ketë efekt një vit pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin.

4. E drejta e denoncimit, parashikuar nga ky nen nuk do të jetë e ushtrueshme nga çdo Palë Kontraktuese përpara përfundimit të pesë viteve nga data në të cilën ky Protokoll hyri në fuqi në lidhje me këtë Palë Kontraktuese.

5. a) Aty ku një markë është subjekt i një regjistrimi ndërkombëtar që ka efekt në shtetin apo organizatën që denoncon, në datën në të cilën denoncimi bëhet efektiv, mbajtësi i këtij regjistrimi mund të depozitojë një aplikim për regjistrimin e së njëjtës markë pranë zyrës së shtetit ose organizatës që denoncon, e cila do të jetë trajtuar sikur kjo të ketë qenë depozituar në datën e regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 3 (4) ose në datën e regjistrimit të shtrirjes territoriale sipas nenit 3ter (2) dhe, në qoftë se regjistrimi ndërkombëtar gëzonte prioritet, të njëjtin prioritet gëzon dhe aplikimi me kusht që:

i) një aplikim i tillë është depozituar brenda dy viteve nga data në të cilën bëhet efektiv denoncimi;

ii) mallrat dhe shërbimet listuar në aplikim janë mbuluar në fakt nga lista e mallrave dhe shërbimeve që përmbante regjistrimi ndërkombëtar përsa i përket shtetit ose organizatës ndërqeveritare që denoncon;

iii) një aplikim i tillë është në pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit në fuqi, duke përfshirë dhe kërkesat lidhur me tarifat.

b) Dispozitat e nënparagrafit (a) do të zbatohen gjithashtu në lidhje me çdo markë që është subjekt i një regjistrimi ndërkombëtar, që ka efekt në Palët Kontraktuese, përveç shtetit ose organizatës ndërqeveritare që denoncon në datën në të cilën bëhet efektiv denoncimi dhe mbajtësi i të cilit, për arsye të denoncimit, nuk ka më të drejtë që të depozitojë aplikime ndërkombëtare sipas nenit 2 (1).

Neni 16 **Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e depozitimit**

1. a) Ky Protokoll nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhët angleze, frënge dhe spanjolle dhe depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm, deri kur ai pushon së qenuri i hapur për nënshkrim në Madrid. Tekstet në tri gjuhët janë barazvlefshme, autentike.

b) Tekstet zyrtare të këtij Protokolli përgatiten nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimeve me qeveritë dhe organizatat e interesuara, në gjuhët arabe, kineze, gjermane, italiane, japoneze, portugeze dhe ruse dhe në gjuhë të tjera, ashtu siç mund të vendosë Asambleja.

2. Ky Protokoll do të mbetet i hapur për nënshkrim në Madrid deri më 31 dhjetor 1989.

3. Drejtori i Përgjithshëm do të përcjellë dy kopje, vërtetuar prej qeverisë spanjolle, të teksteve të nënshkruara të këtij Protokolli të gjitha shteteve dhe organizatave ndërqeveritare, që mund të bëhen Palë të këtij Protokolli.

4. Drejtori i Përgjithshëm do të regjistrojë këtë Protokoll pranë Sekretariatit të Kombeve të

Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, që mund të bëhen ose janë Palë të këtij Protokolli, për nënshkrimet, depozitimet e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit, hyrjen në fuqi të këtij Protokolli dhe çdo ndryshim, për më tepër, çdo njoftim për denoncim dhe çdo deklaram parashikuar në këtë Protokoll.

L I G J
Nr. 8993, datë 30.1.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR THEMELIMIN
E ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË INTELEKTUALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelktuale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3684 , datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

KONVENTA
PËR THEMELIMIN E ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Nënshkruar në Stokholm, më 14 korrik 1967 dhe amenduar më 28 shtator 1979

Palët Kontraktuese:

Duke dëshiruar të kontribuojnë për një mirëkuptim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet shteteve për përfitim të tyre reciprok, mbi bazën e respektit për sovranitetin dhe barazinë e tyre;

Duke dëshiruar, me qëllim që të inkurajojnë aktivitetin krijues, për të nxitur mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën;

Duke dëshiruar të modernizojnë dhe të bëjnë më shumë eficient administrimin e Bashkimeve, të themeluar në fushat e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e veprave letrare e artistike, ndërsa duke respektuar plotësisht pavarësinë e secilit nga Bashkimet,

ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Themelimi i Organizatës

Themelohet Organizata Botërore e Pronësisë Intelktuale

Neni 2 Përcaktime

Për qëllime të kësaj Konvente:

- i) “Organizatë” do të kuptohet Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI).
- ii) “Zyra Ndërkombëtare” do të kuptohet Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale.
- iii) “Konventa e Parisit” do të kuptohet Konventa për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale nënshkruar më 20 mars 1883, duke përfshirë secilin nga rishikimet e saj.
- iv) “Konventa e Bernës” do të kuptohet Konventa për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike e nënshkruar më 20 shtator 1886, duke përfshirë secilin nga rishikimet e saj.
- v) “Bashkimi i Parisit” do të kuptohet Bashkimi Ndërkombëtar i themeluar nga Konventa e Parisit.
- vi) “Bashkimi i Bernës” do të kuptohet Bashkimi Ndërkombëtar i themeluar nga Konventa e Bernës.
- vii) “Bashkimet” do të kuptohet Bashkimi i Parisit, Bashkimet dhe Marrëveshjet e veçanta të themeluara në lidhje me atë Bashkim, Bashkimi i Bernës dhe çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare e caktuar, që të nxisë mbrojtjen e pronësisë intelektuale, administrimi i së cilës është marrë përsipër nga Organizata sipas nenit 4 (iii).
- viii) “Pronësi Intelektuale” do të përfshijë të drejtat në lidhje me:
 - veprat letrare, artistike dhe shkencore,
 - shfaqjet artistike, fonogramat dhe transmetimet,
 - shpikjet në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore,
 - zbulimet shkencore,
 - disenjot industriale,
 - markat tragtare, markat e shërbimit, emrat tregtarë dhe emërtimet e origjinës,mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme dhe të gjitha të drejtat e tjera që rezultojnë nga aktiviteti intelektual, në fushat industriale, shkencore, letrare ose artistike.

Neni 3 Objektivat e Organizatës

Objektivat e Organizatës janë:

- i) Të nxisë mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën nëpërmjet kooperimit ndërmjet shteteve dhe, kur është e përshtatshme, në bashkëpunim me çdo organizatë tjetër ndërkombëtare.
- ii) Të sigurojë kooperimin administrativ ndërmjet shteteve.

Neni 4 Funksionet

Me qëllim që të arrijë objektivat e përshkuara në nenin 3, Organizata, përmes organeve të saj përkatëse dhe në përputhje me kompetencat e secilit prej Bashkimeve:

- i) do të nxisë zhvillimin e masave që synojnë të lehtësojnë mbrojtjen efiçente të pronësisë intelektuale në të gjithë botën dhe të harmonizojë legjislacionin kombëtar në këtë fushë;
- ii) do të kryejë detyra administrative të Bashkimit të Parisit, Bashkimeve të veçanta të themeluara në lidhje me këtë Bashkim dhe Bashkimit të Bernës;
- iii) mund të bjerë dakord të marrë përsipër ose të marrë pjesë në administrimin e çdo marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare, që synon të nxisë mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- iv) do të inkurajojë përfundimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që synojnë në nxisin mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- v) do t’u ofrojë kooperimin shteteve që kërkojnë asistencë tekniko-ligjore në fushën e pronësisë intelektuale;
- vi) do të mbledhë dhe përhapë informacione në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, do të kryejë dhe nxisë studime në këtë fushë dhe do të publikojë rezultatet e studimeve të tilla;
- vii) do të kryejë shërbimet që lehtësojnë mbrojtjen ndërkombëtare të pronësisë intelektuale

dhe, kur është e përshtatshme, do të sigurojë regjistrimin në këtë fushë dhe do të publikojë të dhënat që kanë të bëjnë me regjistrimin;

viii) do të marrë të gjitha veprimet e tjera të përshtatshme.

Neni 5 **Anëtarësimi**

1. Anëtarësimi në Organizatë do të jetë i hapur për çdo shtet, i cili është anëtar i secilit prej Bashkimeve siç përcaktohet në nenin 2 (vii).

2. Anëtarësimi në Organizatë do të jetë i hapur në mënyrë të barabartë për çdo shtet joanëtar i secilit prej Bashkimeve, vetëm në qoftë se:

i) është anëtar i Kombeve të Bashkuara, i çdo agjencie të specializuar që ka lidhje me Kombet e Bashkuara ose Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike ose është Palë në statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë;

ii) ftohet nga Asambleja e Përgjithshme për t'u bërë Palë në këtë Konventë.

Neni 6 **Asambleja e Përgjithshme**

1. a) Do të ketë një Asamble të Përgjithshme të përbërë nga Shtetet Palë në këtë Konventë të cilët janë anëtarë të çdonjërit prej Bashkimeve.

b) Qeveria e çdo shteti do të përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë alternativë, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e çdo delegacioni do të përballohen nga qeveria e cila e ka emëruar atë.

2. Asambleja e Përgjithshme:

i) do të caktojë Drejtorin e Përgjithshëm sipas emërimit të Komitetit të Kordinimit;

ii) do të rishikojë dhe aprovojë raportet e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me Organizatën dhe t'i japë atij të gjitha udhëzimet e nevojshme;

iii) do të rishikojë dhe aprovojë raportet dhe aktivitetet e Komitetit të Kordinimit dhe t'i japë udhëzime këtij Komiteti;

iv) do të vendosë buxhetin 2-vjeçar të shpenzimeve të përbashkëta për Bashkimet;

v) do të aprovojë masat e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm në lidhje me administrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të përmendura në nenin 4 (iii);

vi) do të aprovojë rregulloret financiare të Organizatës;

vii) do të përcaktojë gjuhën e punës së sekretariatit, duke marrë parasysh praktikën e Kombeve të Bashkuara;

viii) do të ftojë shtetet e përmendura në nenin 5 (2) (ii) për t'u bërë Palë e kësaj Konvente;

ix) do të përcaktojë se cilat shtete joanëtare të Organizatës dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në takimet e saj si vëzhgues;

x) do të ushtrojë të tilla funksione të tjera që janë të përshtatshme sipas kësaj Konvente.

3. a) Çdo shtet, anëtar i njërit ose shumë Bashkimeve, do të ketë një votë në Asamblenë e Përgjithshme.

b) Gjysma e shteteve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme do të përbëjë një kuorum.

c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (b), në qoftë se, në çdo sesion, numri i shteteve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por i barbartë ose më shumë se një e treta e shteteve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me procedurën e vet, të gjitha këto vendime të cilat do të kenë efekt vetëm në rast se do të plotësohen kushtet që vijnë. Zyra Ndërkombëtare do t'u komunikojë këto vendime shteteve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme, të cilat nuk janë përfaqësuar dhe do t'i ftojë ata të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Në qoftë se, me mbarimin e kësaj periudhe, numri i shteteve që kanë shprehur për këtë votën ose abstenimin e tyre, arrin numrin e shteteve që mungonte për arritjen e kuoromit në vetë sesionin, vendime të tilla do të kenë efekt me kusht që, në të njëjtën kohë, shumica e kërkuar të ekzistojë akoma.

d) Në varësi të dispozitës së nënparagrafëve (e) dhe (f), Asambleja e Përgjithshme do t'i marrë

vendimet e saj me shumicë prej dy të tretave të votave.

e) Aprovimi i masave në lidhje me administrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të përmendura në nenin (4) (iii) do të kërkojë një shumicë të tre të katërtave të votave.

f) Miratimi i një marrëveshjeje me Kombet e Bashkuara, sipas neneve 57 dhe 63 të Kombeve të Bashkuara do të kërkojë një shumicë prej nëntë të dhjetave të votave.

g) Për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm paragrafi (2) (i), aprovimi i masave të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm, që ka të bëjë me administrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare paragrafi (2) (v), dhe transferimi i selisë neni 10, shumica e kërkuar duhet të arrihet jo vetëm në Asamblenë e Përgjithshme, por gjithashtu në Asamblenë e Bashkimit të Parisit dhe Asamblenë e Bashkimit të Bernës.

h) Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

i) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë në emër vetëm të një shteti.

4) a) Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet një herë në çdo vit të dytë kalendarik në sesion të zakonshëm, sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm.

b) Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm ose me kërkesën e Komitetit të Koordinimit, ose me kërkesën e një të katërtës së shteteve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme.

c) Mbledhjet do të mbahen në selinë e Organizatës.

5. Shtetet Palë në këtë Konventë, të cilët nuk janë anëtare të ndonjërit nga Bashkimet do të pranohen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme si vëzhgues.

6. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë rregullat e veta të procedurës.

Neni 7

Konferenca

1) a) Do të ketë një Konferencë të përbërë nga Shtete Palë të kësaj Konvente qofshin anëtare ose jo të çdonjërit prej Bashkimeve.

b) Qeveria e çdo Shteti do të përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegati alternativ, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e çdo delegacioni do të përballohen nga qeveria, e cila e ka emëruar atë.

2. Konferenca:

i) do të diskutojë çështje të interesit të përgjithshëm në fushën e pronësisë intelektuale dhe mund të adaptojë rekomandime në lidhje me çështje të tilla, që kanë të bëjnë me kompetencat dhe autonominë e Bashkimeve;

ii) do të adaptojë buxhetin dy-vjeçar të Konferencës;

iii) do të krijojë programin dyvjeçar të asistencës legalo-teknike brenda limiteve të buxhetit të Konferencës;

iv) do të adaptojë ndryshimet e kësaj Konvente siç parashikohet në nenin 17;

v) do të përcaktojë se cilat shtete joanëtare të Organizatës dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në takimet e saj si vëzhgues;

vi) do të ushtrojë të tilla funksione të tjera që janë të përshtatshme sipas kësaj Konvente.

3. a) Çdo shtet anëtar do të ketë një votë në Konferencë.

b) Një e treta e shteteve anëtare do të përbëjë një kuorum.

c) Në varësi të dispozitës së nenit 17, Konferenca do t'i marrë vendimet e saj me një shumicë prej dy të tretave të votave.

d) Shumat e kontributeve të Shteteve Palë të kësaj Konvente joanëtare të çdonjërit prej Bashkimeve, do të përcaktohet nga një votë në të cilën vetëm delegatët e këtyre shteteve kanë të drejtën e votës.

e) Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë në emër vetëm të një shteti.

4. a) Konferenca do të mbledhet në sesione të zakonshme sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si dhe Asambleja e Përgjithshme.

b) Konferenca do të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e shumicës së shteteve anëtare.

5. Konferenca do të adaptojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 8
Komiteti i Koordinimit

1. a) Do të ketë një Komitet Koordinimi të përbërë nga Shtetet Palë të kësaj Konvente, të cilët janë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të Bashkimit të Parisit ose Komitetit Ekzekutiv të Bashkimit të Bernës, ose i të dyjave. Sidoqoftë, në qoftë se secili nga këto Komitete Ekzekutive përbëhet prej më shumë se një e katërta e numrit të vendeve anëtare të Asamblesë të cilët zgjedhin atë, atëherë ky Komitet Ekzekutiv do të zgjedhë nga gjiri i anëtarëve të vet, shtetet të cilët do të jenë anëtarë të Komitetit të Koordinimit, në një mënyrë të tillë që numri i tyre të mos kapërcejë një të katërtën e referuar më sipër, duke nënkuptuar që vendi, në territorin e të cilit Organizata ka selinë, nuk do të përfshihet në llogaritjen e kësaj një të katërte.

b) Qeveria e çdo shteti do të përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegati alternativ, këshilltar dhe ekspert.

c) Kurdoherë që Komiteti i Koordinimit shqyrton qoftë çështje të interesit direkt ndaj programit ose buxhetit të Konferencës dhe axhendës së saj, qoftë propozimet për ndryshimin e kësaj Konvente, e cila do të prekë të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë të kësaj Konvente joanëtare të çdonjërit prej Bashkimeve, një e katërta e shteteve të tilla do të marrë pjesë në takimet e Komitetit të Koordinimit me të njëjtat të drejta si anëtarët e atij Komiteti. Konferenca, në çdo sesion të zakonshëm të saj, do të caktojë këto shtete.

d) Shpenzimet e çdo delegacioni do të përballohen nga qeveria e cila e ka emëruar atë.

2. Në qoftë se Bashkimet e tjera të administruara nga Organizata dëshirojnë të përfaqësohen si të tillë në Komitetin e Koordinimit, përfaqësuesit e tyre duhet të emërohen nga gjiri i shteteve anëtare të Komitetit të Koordinimit.

3. Komiteti i Koordinimit:

i) do t'u japë këshilla organeve të Bashkimeve, Asamblesë së Përgjithshme, Konferencës dhe Drejtorit të Përgjithshëm, mbi të gjitha çështjet administrative, financiare dhe të tjera çështje të interesit të përbashkët qoftë dy ose më shumë Bashkimeve, ose dy ose më shumë Bashkimeve dhe Organizatës, dhe në veçanti mbi buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për Bashkimet;

ii) do të përgatisë draftaxhendën e Asamblesë së Përgjithshme;

iii) do të përgatisë draftaxhendën, draftprogramin dhe buxhetin e Konferencës;

iv) [fshirë];

v) do të caktojë një kandidat për emërim në një pozicion të tillë nga Asambleja e Përgjithshme, kur afati i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm është duke përfunduar ose kur ka një vend vakant në postin e Drejtorit të Përgjithshëm; në qoftë se Asambleja e Përgjithshme nuk e emëron kandidatin, Komiteti i Koordinimit do të emërojë një kandidat tjetër; kjo procedurë do të përsëritet derisa kandidati i fundit të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme;

vi) do të caktojë një Drejtor të Përgjithshëm të përkohshëm për afatin që paraprin marrjen e detyrës nga Drejtori i Përgjithshëm i ri, në qoftë se posti i Drejtorit të Përgjithshëm mbetet vakant ndërmjet dy sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme;

vii) do të kryejë funksione të tjera të tilla siç i caktohen sipas kësaj Konvente.

4. a) Komiteti i Koordinimit do të mbledhet një herë në vit në sesion të zakonshëm, sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm. Ai do të mbledhet normalisht në selinë e Organizatës.

b) Komiteti i Koordinimit do të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme, sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm ose me iniciativë të tij, ose me kërkesën e Kryetarit të tij, ose të një të katërtës së anëtarëve të vet.

5. a) Çdo shtet, qoftë ose joanëtar i njërit ose i të dy Komiteteve Ekzekutive të përmendur në paragrafin (1) (a), do të ketë një votë në Komitetin e Koordinimit.

b) Gjysma e anëtarëve të Komitetit të Koordinimit do të përbëjë një kuorum.

c) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë në emër, vetëm të një shteti.

6. a) Komiteti i Koordinimit do të shprehë opinionet e tij dhe do të marrë vendimet e veta me një shumicë të thjeshtë të votave të hedhura. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

b) Edhe sikur një shumicë e thjeshtë të arrihet, çdo anëtar i Komitetit të Koordinimit, menjëherë pas votës, mundet të kërkojë që votat t'i nënshtrohen një rinumërimi të ri sipas kësaj mënyre: dy lista të ndara do të përgatiten, njëra që përmban emrat e shteteve anëtare të Komitetit

Ekzekutiv të Bashkimit të Parisit dhe tjetra, emrat e shteteve anëtare të Komitetit Ekzekutiv të Bashkimit të Bernës; vota e çdo shteti do të shënohet përbri emrit të tij në secilën listë në të cilën shfaqet. Kur ky rinumërim special tregon se një shumicë e thjeshtë nuk është arritur në secilën prej këtyre listave, propozimi nuk do të konsiderohet si i kryer.

7. Çdo shtet anëtar i Organizatës, i cili nuk është anëtar i Komitetit të Koordinimit, mund të përfaqësohet në mbledhjet e Komitetit nga vëzhguesit që kanë të drejtën e pjesëmarrjes në debate, por pa të drejtë vote.

8. Komiteti i Koordinimit do të përcaktojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 9

Zyra Ndërkombëtare

1. Zyra Ndërkombëtare do të jetë Sekretariati i Organizatës.

2. Zyra Ndërkombëtare do të drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i asistuar nga dy ose më shumë Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm.

3. Drejtori i Përgjithshëm do të emërohet për një afat të caktuar, i cili nuk do të jetë më pak se gjashtë vjet. Ai gëzon të drejtën për riemërim për afate të caktuara. Periudha e emërimit të parë dhe emërimet e mundshme të mëtejshme, sikurse edhe të gjitha kushtet e tjera të emërimit, do të caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

4. a) Drejtori i Përgjithshëm do të jetë shefi ekzekutiv i Organizatës.

b) Ai do të përfaqësojë Organizatën.

c) Ai do t'i raportojë, konform udhëzimeve, Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështjet e brendshme dhe të jashtme të Organizatës.

5. Drejtori i Përgjithshëm do të përgatisë programet, buxhetin dhe raportet periodike mbi aktivitetet. Ai do t'ia transmetojë ato qeverive të shteteve të interesuara dhe organeve kompetente të Bashkimeve dhe Organizatës.

6. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit të caktuar prej tij do të marrë pjesë pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, Konferencës, Komitetit të Koordinimit dhe çdo komiteti tjetër ose grupi pune. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit të caktuar prej tij do të jenë ex officio sekretari i këtyre organizmave.

7. Drejtori i Përgjithshëm do të caktojë stafin e nevojshëm për kryerjen efikente të detyrave të Zyrës Ndërkombëtare. Ai do të caktojë Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm pas aprovimit nga Komiteti i Koordinimit. Kushtet e punësimit do të caktohen nga rregulloret e stafit të aprovuara nga Komiteti i Koordinimit me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm. Konsiderata kryesore në punësimin e stafit dhe në përcaktimin e kushteve të shërbimit do të jetë nevoja e sigurimit të standardeve më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe ndershmërisë. Kujdes i duhur do t'i kushtohet rëndësisë së rekrutimit të stafit mbi një bazë sa më të gjerë gjeografike që të jetë e mundur.

8. Natyra e përgjegjësisë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të stafit do të jetë ekskluzivisht ndërkombëtare. Në kryerjen e detyrave të tyre, ata nuk do të kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë qeveri, ose nga asnjë autoritet i jashtëm nga Organizata. Ata nuk do të kryejnë asnjë veprim i cili mund të paragjykojë pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë. Çdo shtet anëtar merr përsipër të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësisë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të stafit dhe nuk kërkon t'i influencojë ata në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 10

Selia

1. Selia e Organizatës do të jetë në Gjenevë.

2. Transferimi i saj mund të vendoset siç parashikohet në nenin 6 (3) (d) dhe (g).

Neni 11

Financat

1. Organizata do të ketë dy buxhete të ndara: buxheti i shpenzimeve të përbashkëta të Bashkimeve dhe buxheti i Konferencës.

2. a) Buxheti i shpenzimeve të përbashkëta të Bashkimeve do të përfshijë dispozita për shpenzimet e interesit ndaj disa Bashkimeve.

b) Ky buxhet do të financohet nga burimet e mëposhtme:

i) kontributet e Bashkimeve me kusht që shumata e kontributeve për çdo Bashkim do të caktohet nga Asambleja e atij Bashkimi, duke marrë parasysh interesin që Bashkimi ka në shpenzimet e përbashkëta;

ii) pagesat për shërbime të kryera nga Zyra Ndërkombëtare jo në lidhje direkte me ndonjërin nga Bashkimet ose jo të marra për shërbimet e bëra nga Zyra Ndërkombëtare në fushën e asistencës legalo-teknike;

iii) shitja ose pagesat e publikimeve të Zyrës Ndërkombëtare, që nuk lidhen direkt me asnjërin prej Bashkimeve;

iv) dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione, të dhëna Organizatës, përveç atyre të përmendura në paragrafin (3) (b) (i);

v) qira, interesa dhe çdo e ardhur tjetër e ndryshme e Organizatës.

3. a) Buxheti i Konferencës do të përfshijë dispozita për shpenzimet e mbajtjes së sesioneve të Konferencës dhe për kostot e programit të asistencës legalo-teknike.

b) Ky buxhet do të financohet nga burimet e mëposhtme:

i) kontribute të shteteve anëtare të kësaj Konvente joanëtare të ndonjërit prej Bashkimeve;

ii) çdo shumë e vënë në dispozicion në këtë buxhet nga Bashkimet, me kusht që sasia e shumës së vënë në dispozicion nga çdo Bashkim do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme e atij Bashkimi dhe se çdo Bashkim do të jetë i lirë që të abstenojë nga kontributet e këtij buxheti;

iii) shumata të marra për shërbime të kryera nga Zyra Ndërkombëtare në fushën e asistencës legalo-teknike;

iv) dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione të dhëna Organizatës, për qëllime të përmendura në nënparagrafin (a).

4. a) Për qëllimin e krijimit të kontributeve të veta ndaj buxhetit të Konferencës, çdo Shtet Palë e kësaj Konvente joanëtar i ndonjërit prej Bashkimeve, do t'i përkasë një klase dhe do të paguajë kontributet e veta vjetore mbi bazën e një numri njësisht të caktuara si vijon:

Klasa A.....10

Klasa B..... 3

Klasa C1

b) Çdo shtet, në përputhje me marrjen e masave siç parashikohet në nenin 14, do të tregojë klasën të cilës dëshiron t'i përkasë. Çdo shtet i tillë mund të ndryshojë klasë. Në qoftë se zgjedh një klasë më të ulët, shteti duhet t'ia deklarojë atë Konferencës në një nga sesionet e zakonshme të saj. Çdo ndryshim i tillë do të ketë efekt në fillim të vitit kalendarik që vijon sesionin.

c) Kontributi vjetor i çdo shteti do të jetë një sasi në të njëjtin proporcion me shumën totale të kontribuar në buxhetin e Konferencës nga të gjitha shtetet sa numri i njësisve të tij është ndaj totalit të njësisve të të gjithë këtyre shteteve.

d) Kontributet do të bëhen të pagueshme më një janar të çdo viti.

e) Në qoftë se buxheti nuk është adaptuar përpara fillimit të periudhës së re financiare, buxheti do të jetë në të njëjtin nivel si buxheti i vitit të mëparshëm, në përputhje me rregulloret financiare.

5. Çdo Shtet Palë e kësaj Konvente joanëtar i ndonjërit prej Bashkimeve, i cili është prapa në pagesën e kontributit të tij financiar sipas këtij neni dhe çdo Shtet Palë e kësaj Konvente anëtar i çdonjërit prej Bashkimeve, i cili është prapa në pagesën e kontributit të tij financiar ndaj çdonjërit prej Bashkimeve, nuk do të ketë votë në asnjë prej organizmave të Organizatës, anëtarë e së cilës është, në qoftë se shumata e prapambetur e tij është e barabartë ose tejkalon shumën e kontributeve që i detyrohet asaj për dy vite të mëparshme të plota.

6. Shumata e tarifave dhe pagesave të papaguara për shërbimet e bëra nga Zyra Ndërkombëtare në fushën e asistencës legalo-teknike do të përcaktohet dhe do t'i raportohet Komitetit të Koordinimit, nga Drejtori i Përgjithshëm.

7. Organizata, me aprovimin e Komitetit të Koordinimit, mund të pranojë dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione, direkt nga qeveritë, institucionet publike e private, shoqatat ose persona privatë.

8. a) Organizata do të ketë një fond kapital pune, i cili do të përbëhet nga një pagesë e vetme nga Bashkimet dhe nga çdo Shtet Palë e kësaj Konvente joanëtar i ndonjërit prej Bashkimeve. Në

qoftë se fondi bëhet i pamjaftueshëm, ai do të rritet.

b) Shuma e pagesës së vetme të çdonjërit Bashkim dhe pjesëmarrja e mundshme e tij në një rritje do të vendoset nga Asambleja e tij.

c) Shuma e pagesës së vetme të çdonjërit Shtet Palë e kësaj Konvente joanëtar i ndonjërit prej Bashkimeve dhe pjesa e tij në çdo rritje, do të jetë një proporcion i kontributeve të atij shteti për vitin në të cilin u krijua fondi ose u vendos rritja e tij. Proporcioni dhe termat e pagesës do të caktohen nga Konferenca me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi është dëgjuar edhe këshilla e Komitetit të Koordinimit.

9. a) Në marrëveshjen për selinë, të përfunduar me shtetin në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, do të parashikohet se sa herë që fondi kapital i punës është i pamjaftueshëm, ky shtet do të japë shuma paraprake. Shuma paraprake dhe kushtet në të cilat ato janë dhënë do të jenë subjekt i një marrëveshjeje të veçantë, në çdo rast, ndërmjet Shtetit dhe Organizatës. Për aq sa qëndron nën detyrimin për të dhënë paraprakisht, ky shtet do të ketë një vend ex officio në Komitetin e Koordinimit.

b) Shteti i përmendur në nënparagrafin (a) dhe Organizata do të kenë secili të drejtën për të denoncuar detyrimin për të dhënë shuma paraprake, sipas njoftimit me shkrim. Denoncimi do të ketë efekt tre vjet pas mbarimit të vitit në të cilin është bërë njoftimi.

10. Auditimi i llogarive do të kryhet nga një ose më shumë shtete anëtare ose nga auditorë të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ata do të caktohen, me miratimin e tyre, nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

Kapaciteti ligjor, privilegjet dhe imunitetet

1. Organizata do të gëzojë në territorin e çdo shteti anëtar, në përputhje me ligjet e atij shteti, zotësi të tillë ligjore që të mund të jetë e nevojshme për përmbushjen e objektivave të Organizatës dhe për ushtrimin e funksioneve të saj.

2. Organizata mund të përfundojë një marrëveshje për selinë me Konfederatën Zvicerane dhe me çdo shtet tjetër në të cilin mund të vendoset më pas.

3. Organizata mund të përfundojë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me shtetet e tjera anëtarë me qëllim të gëzimit nga ana e Organizatës, zyrtarëve të saj dhe përfaqësuesve të të gjitha shteteve anëtarë, të privilegjeve dhe imuniteteve të tilla sa të mund të jenë të nevojshme për përmbushjen e objektivave të saj dhe për ushtrimin e funksioneve të saj.

4. Drejtori i Përgjithshëm mund të negociojë dhe, pas miratimit të Komitetit të Koordinimit, do të përfundojë dhe do të nënshkruajë në emër të Organizatës marrëveshjen e përmendur në paragrafët (2) dhe (3).

Neni 13

Marrëdhëniet me organizata të tjera

1. Organizata, kur është e përshtatshme, do të vendosë marrëdhënie dhe do të koeporojë me organizata të tjera ndërqeveritare. Çdo marrëveshje e përgjithshme me efekt të tillë, e lidhur me këto organizata, do të përfundohet nga Drejtori i Përgjithshëm pas aprovimit nga Komiteti i Koordinimit.

2. Organizata, për çështje brenda kompetencave të saj, do të bëjë marrëveshje të përshtatshme për konsultimin dhe kooperimin me organizata joqeveritare dhe, me miratimin e Qeverisë së interesuar, me organizata kombëtare, qeveritare ose joqeveritare. Të tilla veprime do të bëhen nga Drejtori i Përgjithshëm pas aprovimit nga Komiteti i Koordinimit.

Neni 14

Bërja Palë e Konventës

1. Shtetet e përmendura në nenin 5 mund të bëhen Palë e kësaj Konvente dhe anëtarë të Organizatës me:

i) nënshkrimin pa rezerva në lidhje me ratifikimin;

ii) nënshkrimin në varësi të ratifikimit të ndjekur nga depozitimi i një instrumenti ratifikimi;

iii) depozitimi i një instrumenti aderimi.

2. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e kësaj Konvente, një Shtet Palë e Konventës së Parisit, Konventës së Bernës ose të të dyja Konventave, mund të bëhet Palë e kësaj Konvente vetëm në qoftë se në të njëjtën kohë ratifikon ose pranon në, ose vetëm pasi ka ratifikuar ose aderuar në:

ose në Aktin – Ligjin e Stokholmit të Konventës së Parisit në tërësinë e vet ose vetëm me kufizimet e parashtruara në nenin 20 (1) (b) (i) të saj;

ose në Aktin – Ligjin e Stokholmit të Konventës së Bernës në tërësinë e vet ose vetëm me kufizimet e parashtruara në nenin 28 (1) (b) (i) të saj.

3. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 15

Hyrja në fuqi e Konventës

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi dhjetë shtete anëtarë të Bashkimit të Parisit dhe shtatë shtete anëtarë të Bashkimit të Bernës kanë marrë veprime siç parashikohet në nenin 14 (1), duke u nënkuptuar se, një shtet anëtar i të dy Bashkimeve do të numërohet në të dy grupet. Në atë datë, kjo Konventë do të hyjë në fuqi gjithashtu në lidhje me shtete të cilët, duke mos qenë anëtarë të asnjërit prej dy Bashkimeve, kanë marrë veprime siç parashikohet në nenin 14 (1) tre muaj ose më shumë përpara asaj dite.

2. Në lidhje me çdo shtet tjetër, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën ky shtet merr veprime siç parashikohet në nenin 14 (1).

Neni 16

Rezervat

Nuk lejohet asnjë rezervë ndaj kësaj Konvente.

Neni 17

Ndryshimet

1. Propozimet për ndryshimin e kësaj Konvente mund të fillohen nga shtetet anëtarë, nga Komiteti i Koordinimit ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto propozime do t'u komunikohen shteteve anëtarë nga Drejtori i Përgjithshëm të paktën gjashtë muaj përpara konsiderimit të tyre nga Konferenca.

2. Ndryshimet do të adaptohen nga Konferenca. Kurdoherë që ndryshimet do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e shteteve Palë të kësaj Konvente joanëtarë të çdonjerit prej Bashkimeve, ky shtet gjithashtu do të votojë. Për të gjitha ndryshimet e tjera të propozuara, vetëm shtetet Palë të kësaj Konvente anëtarë të çdo Bashkimi do të votojnë. Ndryshimet do të adaptohen nga një shumicë e thjeshtë votash të hedhura, me kusht që Konferenca do të votojë vetëm mbi këto propozime për ndryshime siç është adaptuar më përpara nga Asambleja e Bashkimit të Parisit dhe Asambleja e Bashkimit të Bernës, sipas rregullave të aplikueshme prej tyre në lidhje me adaptimin e ndryshimeve ndaj dispozitave administrative të Konventave të tyre përkatëse.

3. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi një muaj pas lajmërimit me shkrim të pranimit, i kryer në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, që është marrë nga Drejtori i Përgjithshëm nga tre të katërtat e shteteve anëtarë të Organizatës, që kanë të drejtë të votojnë për propozimet për ndryshime sipas paragrafit (2), në kohën kur Konferenca adaptoi ndryshimin. Çdo ndryshim i pranuar në këtë mënyrë do të detyrojë të gjitha shtetet të cilët janë anëtarë të Organizatës në kohën, kur ndryshimi hyn në fuqi ose të cilët bëhen anëtarë në një datë të mëvonshme, me kusht që çdo ndryshim tjetër që rrit detyrimet financiare të shteteve anëtarë do të detyrojë vetëm ato shtete, të cilat e kanë njoftuar pranimin e tyre për një ndryshim të tillë.

Neni 18

Denoncimi

1. Çdo shtet anëtar mund të denoncojë këtë Konventë nëpërmjet njoftimit drejtuar Drejtorit të

Përgjithshëm.

2. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftim.

Neni 19 **Njoftimet**

Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë qeveritë e të gjitha shteteve anëtarë për:

- i) datën e hyrjes në fuqi të Konventës,
- ii) nënshkrimin dhe depozitimin e instrumenteve të ratifikimit ose pranimit,
- iii) pranimin e një ndryshimi të kësaj Konvente dhe datën në të cilin ky ndryshim hyn në fuqi,
- iv) denoncimet e kësaj Konvente.

Neni 20 **Dispozita përfundimtare**

1. a) Kjo Konventë do të nënshkruhet në një kopje të vetme në anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, duke qenë të gjithë tekstet në mënyrë të barabartë autentike dhe do të depozitohen pranë Qeverisë së Suedisë.

b) Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur për nënshkrim në Stokholm deri më 13 janar 1968.

2. Tekstet zyrtare do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhët gjermanisht, italisht dhe portugalisht dhe çdo gjuhë tjetër siç mund ta caktojë Konferenca.

3. Drejtori i Përgjithshëm do t'i transmetojë dy kopje të vërtetuara të kësaj Konvente dhe të çdo ndryshimi të adaptuar nga Konferenca Qeverive të Shteteve Anëtare të Bashkimeve të Parisit ose Bernës, qeverisë së çdo shteti tjetër kur pranon këtë Konventë dhe me kërkesë, qeverisë së çdo shteti tjetër. Kopjet e teksteve të nënshkruara të Konventës transmetuar qeverive do të vërtetohen nga Qeveria e Suedisë.

4. Drejtori i Përgjithshëm do ta regjistrojë këtë Konventë pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 21 **Dispozita tranzitore**

1. Derisa Drejtori i parë i Përgjithshëm të marrë detyrën, referimet në këtë Konventë për Zyrën Ndërkombëtare ose të Drejtorit të Përgjithshëm do të konsiderohen se janë referime për Zyrën Ndërkombëtare të Bashkuar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, Letrare dhe Artistike (e quajtur gjithashtu Zyra Ndërkombëtare e Bashkuar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (BIRPI), ose Drejtorit të saj, përkatësisht.

2. a) Shtetet, të cilët janë anëtarë e çdonjërit prej Bashkimeve, por që nuk janë bërë Palë e kësaj Kontrate, për pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në rast se dëshirojnë, mund të ushtrojnë të njëjtat të drejta sikur ata të ishin bërë Palë e kësaj Konvente. Çdo shtet që dëshiron të ushtrojë të drejta të tilla do t'i japë njoftim me shkrim në lidhje me këtë Drejtorit të Përgjithshëm; ky njoftim do të bëhet efektiv në datën e marrjes së tij. Shtete të tilla do të konsiderohen se janë anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme dhe Konferencës deri në përfundim të kësaj periudhe.

b) Pas përfundimit të kësaj periudhe pesë vjeçare, këto shtete nuk do të kenë të drejtë të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme, Konferencë dhe në Komitetin e Koordinimit.

c) Pas bërjes Palë në këtë Konventë, këto shtete do të rifitojnë të drejtën e tyre të votës.

3. a) Për sa kohë ka shtete anëtarë të Bashkimeve të Parisit dhe Bernës, të cilët nuk janë bërë Palë e kësaj Konvente, Zyra Ndërkombëtare dhe Drejtori i Përgjithshëm do të funksionojnë gjithashtu si Zyra Ndërkombëtare e Bashkuar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, Letrare dhe Artistike dhe drejtori i saj përkatësisht.

b) Staf i në punësim pranë kësaj Zyre në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, gjatë periudhës tranzitore të përmendur në nënparagrafin (a), do të konsiderohet gjithashtu si i punësuar nga Zyra Ndërkombëtare.

4. a) Kur të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit të Parisit janë bërë anëtarë të Organizatës, të drejtat, detyrimet dhe pronat e zyrës së këtij Bashkimi do t'i kalojnë Zyrës Ndërkombëtare të Organizatës.

5. b) Kur të gjitha shtetet anëtarë të Bashkimit të Bernës janë bërë anëtarë të Organizatës, të drejtat, detyrimet dhe pronat e Zyrës së këtij Bashkimi do t'i kalojnë Zyrës Ndërkombëtare të Organizatës.

L I G J
Nr. 8994, datë 30.1.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES TEKNIKE NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR VEPRIMTARINË E BASHKËPUNIMIT DHE TË ASISTENCËS, PËR RISTRUKTURIMIN E ZONËS NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË VLORË DHE ATË TË PISTËS SË FLUTURIMIT NË PISH-PORO”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Italisë për veprimtarinë e bashkëpunimit dhe të asistencës, për rristurimin e zonës në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe atë të pistës së fluturimit në Pish-Poro”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3685, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE
TEKNIKE NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS ITALIANE

Lidhur me aktivitetin e bashkëpunimit dhe asistencës për rristurimin e zonës në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe atë të pistës së fluturimit në Pish-Poro

Parathënie

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane, të quajtura në vazhdim “Palë”:

Në bazë të Marrëveshjes NATO (SOFA) PfP, të datës 29 prill 1991, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8034, datë 22.11.1995;

Në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, mbi bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, firmosur në Romë, më datë 13 tetor

1995, ratifikuar me ligjin nr. 8128, datë 22 korrik 1996 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 48, datë 18 shkurt 1999 nga Parlamenti Italian;

Në bazë të dekretit ligj nr. 1, datë 13 janar 1998 të Parlamentit Italian, koordinuar me ligjin e konvertuar nr. 42, datë 13 mars 1998 “Dispozita urgjente në fushën e bashkëpunimit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë në sektorin e mbrojtjes, si dhe zgjatje e qëndrimit të kontigjenteve ushtarake italiane në Bosnje-Hercegovinë, zgjatje e pjesëmarrjes së vëzhguesve italianë në grupin e vëzhguesve në Herbon”;

Në bazë të dekretit nr. 415, të datës 28 dhjetor 2001, i ndryshuar me ligjin nr. 15, datë 27 shkurt 2002 dhe dekretin nr. 64, datë 16 prill 2002, i kthyer me ligjin nr. 116, datë 15 qershor 2002 “Dispozita urgjente për vazhdimin e pjesëmarrjes italiane në operacionet ushtarake ndërkombëtare”;

Në bazë të ligjit të kontabilitetit të përgjithshëm të Shtetit R.D nr. 2440 të vitit 1923 dhe rregulloren përkatëse me ndryshimet e mëvonshme, D.P.R. nr. 1076 të vitit 1976 dhe D.P.R. nr. 384 të vitit 2001;

Duke konsideruar faktin që, Pala shqiptare ka kërkuar ristrukturimin e infrastrukturave logjistike stërvitore të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë dhe risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pish - Poro;

Duke pasur parasysh “Deklaratën paraprake”, nënshkruar në Tiranë, më 15 qershor 2000, nga Ministrat e Mbrojtjes të të dy vendeve;

Duke pasur parasysh vullnetin e shprehur nga Ministrat e Mbrojtjes me letrat, me datë 28 qershor 2002 dhe 12 korrik 2002,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve reciproke që Palët marrin përsipër për venien në zbatim të aktiviteteve të filluara, që me Marrëveshjen, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane “Lidhur me aktivitetin e bashkëpunimit dhe asistencës për ristrukturimin e infrastrukturave logjistike dhe stërvitore në Akademinë e Forcave Ajrore në Vlorë dhe për risistemimin e pistës së fluturimit prej dheu në Pish-Poro”, të firmosur në Romë, më 7 maj 2001 dhe në Tiranë, më 4 qershor 2001 (që nga ky moment do të quhet Marrëveshje e mëparshme) dhe në bazë të së cilës, kjo Marrëveshje është një vazhdim dhe një plotësim natyral.

2. Në bazë të aktiviteteve të parashikuara nga projekti i ristrukturimit të Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë, Palët kanë shprehur qëndrimet e tyre pozitive për të përcaktuar forma të tjera bashkëpunimi në sektorin stërvitor të aviacionit. Në këtë kontekst, mund të bihet dakord për iniciativa që kanë të bëjnë me fillimin e programeve, me qëllim shkëmbimin e personelit dhe gjithashtu për dërgimin e ekspertëve ushtarakë italianë, pranë Akademisë së Forcave Ajrore, me detyra konsulence për aktivitetet e fluturimit dhe të mësimin të lëndëve teknike, që studiohen në këtë Akademi; kjo në bazë të Protokollit Teknik ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Italiane “Mbi përmbushjen e Marrëveshjes ndërqeveritare për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes”, firmosur në Romë, më datë 28 gusht 1997.

Neni 2

Kryerja e punimeve

1. Aktiviteti i bashkëpunimit dhe asistencës ndërmjet Palëve, nëse nuk vendoset ndryshe nga kjo Marrëveshje, do të zhvillohet siç është përcaktuar në Protokollin e datës 28 gusht 1997.

2. Pala italiane merr përsipër të ofrojë konsulencë dhe asistencë teknike si në fazën projektuese ashtu edhe në fazën ekzekutive të punimeve, të sigurojë furnizimin me materiale të nevojshme për realizimin dhe kryerjen e punimeve.

3. Pala italiane do të përjashtohet nga taksat dhe detyrimet doganore, që zbatohen në Shqipëri, për personelin dhe materialet e nevojshme për zhvillimin e punimeve që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Drejtimi i punimeve, krahu i punës dhe materialet

1. Pala italiane do të japë:
 - projektues, konsulentë punimesh, asistencë, krah pune;
 - materiale për ndërtim dhe pajisje.
2. Është e drejta e Palës shqiptare, në mirëkuptim me Palën italiane, të ndihmojë pa kërkuar në shkëmbim asgjë, me gjithçka të përcaktuar në pikën e mëposhtme.
3. Organizimi i punës është një e drejtë e padiskutueshme e Palës italiane.

Neni 4

Përgjegjësitë

1. Pala italiane angazhohet në kryerjen e punimeve sipas rregullave të normativës së punës dhe normativave projektuese kombëtare italiane dhe si të tilla nënkuptohen të pranuar dhe të aprovuara nga Pala shqiptare.
2. Përgjegjësit, në nivele të ndryshme të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, janë të detyruar të kryejnë punimet “sipas rregullave të normativës së punës”. Kjo do të thotë që Pala shqiptare nuk do të pretendojë nga Pala italiane asgjë në lidhje me pasojat e drejtpërdrejta ose jo, të menjëhershme ose të ardhme, të çfarëdolloj natyre, pasoja të cilat rrjedhin nga realizimi i punimeve.
3. Është e drejta e Palës shqiptare të emërojë një drejtor të punimeve, i cili do të punojë së bashku me atë italian dhe mendimet teknike të të cilit, në rast se ato nuk përputhen me ato të drejtorit italian, do të njoftohen me shkresë dhe në rast mosmarrëveshje, të dyja Palët duhet të konsultohen në një mbledhje dhe duhet të bien dakord; vendimet e kësaj mbledhjeje duhet të shkruhen në një procesverbal të posaçëm.

Neni 5

Personeli italian

1. Pala italiane, për kryerjen e detyrave të caktuara nga kjo Marrëveshje dhe për ruajtjen në brendësi të zonës së punimeve, të personelit, të infrastrukturave, të materialeve dhe të mjeteve të punës, është e autorizuar që të dërgojë dhe të vendosë në Shqipëri, në zonën e Vlorës, një njësi logjistike të Forcave Ajrore ushtarake italiane me elemente riparimi, mirëmbajtje, ruajtje dhe sigurie, me një trupë jo më shumë se 200 persona.
2. Personeli italian në Shqipëri gëzon statusin juridik të parashikuar nga Marrëveshja e NATO-s (SOFA) PpP dhe nga Protokolli i saj shtesë.

Neni 6

Detyrimet shtesë

1. Pala shqiptare angazhohet:
 - Të garantojë hyrjen e mjeteve të transportit tokësor dhe ajror ushtarake italiane, dhe përdorimin e infrastrukturave të zonës së Akademisë së Forcave Ajrore në Vlorë si dhe të pistës së fluturimit prej dheu në Pish-Poro, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.
 - Të vendosë në dispozicion vendet ku do të vendoset zona e kantierit.
 - Të japë ndihmë logjistike të plotë për personelin e vet dhe për automjetet e veta në përdorim, për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të asaj që parashikohet nga pika 2.
 - Të vendosë në dispozicion zona të përshtatshme dhe infrastruktura në të cilat do të vendosen, magazinohen dhe ruhen të gjitha materialet, mjetet dhe veglat, që do të përdoren gjatë punimeve.
 - Të garantojë, me ndihmën e policisë ushtarake, ruajtjen e vazhdueshme në zonat e kantierit, të personelit, të infrastrukturave, të materialeve, të mjeteve dhe të çfarëdolloj gjëje, që do të përdoren gjatë punimeve për të cilën bën fjalë kjo Marrëveshje.
2. Pala italiane angazhohet të sigurojë:
 - mbështetjen e plotë logjistike;
 - ushqim për personelin e të dy Palëve të punësuar në zonat e kantierëve;

- karburantet dhe lubrifikantet për të gjitha mjetet e kantierit të përdorura nga Pala shqiptare;
- ndihmën në mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve, duke u kufizuar në ato të dhëna nga Pala italiane, me përjashtim të pjesëve të këmbimit.

Neni 7

Përdorimi i armëve

Personeli italian i pranishëm në tokën shqiptare, si rrjedhojë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të përdorë armët për vetëmbrojtje, eskortë dhe shoqërim autokolonash, në zbatim të ligjit nr. 8290, datë 24 shkurt 1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit” të Republikës së Shqipërisë, për aq sa pajtohet me sistemin juridik italian dhe gjithmonë nëse do të jetë efikas për sigurinë e vet. Përsa më sipër do të kushtohet vëmendje që të punohet me mirëkuptim ndërmjet dy Palëve.

Neni 8

Asistencë shëndetësore

1. Pala italiane i siguron asistencë shëndetësore personelit të saj në bazë të rregullave të saj kombëtare.
2. Pala italiane do të ofrojë ndihmë mjekësore në rastet urgjente Palës shqiptare, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe dhe njoftuar me shkrim.
3. Në rastet kur i ofrohet ndihmë mjekësore Palës shqiptare, do të zbatohet dispozita e nenit 4, pika 2.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi i Marrëveshjes, do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve me Palët, pa u drejtuar palëve të treta.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje ka një vlefshmëri 6 (gjashtë) mujore dhe me të drejtë përsëritje automatikisht për 6 (gjashtë) muaj të tjerë.
 2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi përkohësisht, atëherë kur Palët të kenë nënshkruar dhe përfundimisht kur të kenë njoftuar njëra-tjetrën, për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
 3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo moment, me pëlqimin paraprak, të shkruar, të të dyja Palëve.
 4. Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet nga njëra Palë, me një njoftim me shkrim, 30 (tridhjetë) ditë përpara.
- Kjo Marrëveshje teknike u firmos në Tiranë, më 1 tetor 2002 në tri origjinale, secili në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, ku kjo e fundit do të përdoret si bazë referimi në rast mosmarrëveshje.

L I G J

Nr. 8995, datë 30.1.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË ATOMIKE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen për privilegjet dhe imunitetet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3686, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE
PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË
ATOMIKE

Duke pasur parasysh nenin XV.C të statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike që siguron se pozita ligjore, privilegjet dhe imunitetet që referohen në këtë nen do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë ose marrëveshje ndërmjet Agjencisë, të përfaqësuar për këtë qëllim nga Drejtori i Përgjithshëm, që vepron sipas udhëzimeve të Bordit të Governorëve dhe shteteve anëtare;

Duke pasur parasysh që një Marrëveshje që rregullon lidhjet ndërmjet Agjencisë dhe Kombeve të Bashkuara është miratuar në përputhje me nenin XVI të statutit të saj; Duke pasur parasysh që Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara duke synuar unifikimin me sa të jetë e mundur të privilegjeve dhe imuniteteve që gëzojnë nga Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e ndryshme që kanë hyrë në lidhje me Kombet e Bashkuara, ka adaptuar Konventën për privilegjet dhe imunitetet e Agjencive të specializuara dhe një numër shtetesh anëtarë të Kombeve të Bashkuara kanë aderuar në të.

Bordi i Governorëve:

1. Ka miratuar, pa zotimin e qeverive që përfaqësohen në Bord, tekstin e mëposhtëm, i cili në përgjithësi ndjek Konventën për privilegjet dhe imunitetet e Agjencive të specializuara.

2. Fton shtetet anëtarë të Agjencisë të kenë parasysh dhe nëse e shohin të përshtatshme, të pranojnë këtë Marrëveshje.

Neni 1

Përkufizime

Seksioni 1. Në këtë Marrëveshje:

i) Shprehja “Agjencia” nënkupton Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.
ii) Për qëllimet e nenit III, fjala “pasuri dhe asete” do të përfshijë gjithashtu pasurinë dhe fondet në ruajtje të Agjencisë ose të administruara nga Agjencia në përputhje me funksionet e saj statutore.

iii) Për qëllimet e nenit V dhe VIII, shprehja “përfaqësuesit e shteteve anëtare” do të nënkuptojë të gjithë Governorët, përfaqësuesit, zëvendësit, këshilltarët, ekspertët teknikë dhe sekretariatet e delegacioneve të përfshirë në të;

iv) Në seksionet 12,13,14 dhe 27, shprehja “takimet e thirrura nga Agjencia” do të nënkuptojë takimet:

1. e Konferencës së saj të Përgjithshme dhe të Bordit të saj të Governorëve;
2. e çdo konference ndërkombëtare, simpoziumi, seminari ose paneli të thirrur nga ajo; dhe
3. e çdo komiteti të këtyre organizmave.

v) Për qëllimet e neni VI dhe IX, shprehja “zyrtarë të agjencisë” do të nënkuptojë Drejtorin e Përgjithshëm dhe të gjithë anëtarët e stafit të Agjencisë me përjashtim të atyre që rekrutohen nga personeli vendas dhe emërohen me pagesë orare.

Neni 2

Personaliteti juridik

Seksioni 2. Agjencia është person juridik. Ajo do të ketë aftësinë (a) për të kontraktuar, (b) për të pasur dhe disponuar pasuri të tundshme dhe të patundshme dhe (c) të institucionalizojë veprimet ligjore.

Neni 3

Pasuria, fondet dhe asetet

Seksioni 3. Agjencia, pasuritë dhe asetet e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, do të gëzojnë imunitet nga çdo formë e procedurave ligjore, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë kur në mënyrë të shprehur i është hequr imuniteti. Megjithatë kuptohet që asnjë heqje e imunitetit nuk do të shtrihet në masë ekzekutive.

Seksioni 4. Ndërtesat e Agjencisë janë të padhunueshme. Pasuria dhe asetet e Agjencisë, kudo që ato janë vendosur dhe nga kushdo që mbahen, do të kenë imunitet nga kërkimi, rekuizimi, konfiskimi, tjetërsimi dhe nga çdo formë tjetër e ndërhyrjes qoftë me veprim ligjor, gjyqësor, administrativ ose ekzekutiv.

Seksioni 5. Arkivat e Agjencisë dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i përkasin asaj ose që mbahen prej saj, do të jenë të padhunueshme kudo që ata ndodhen.

Seksioni 6. Pa qenë e kufizuar nga kontrolli financiar, rregulloret ose moratoriumet e çdo lloji:

a) Agjencia mund të mbajë fonde, ar ose monedha të çdo lloji dhe të kryejë veprime me çdo monedhë.

b) Agjencia mund të transferojë lirisht fondet, arin dhe monedhat e saj nga një vend në një tjetër ose brenda çdo vendi dhe të konvertojë çdo monedhë që ajo mban në një monedhë tjetër.

Seksioni 7. Agjencia, gjatë ushtrimit të të drejtave të saj sipas seksionit 6, do t'i kushtojë vëmendjen e duhur çdo kontestimi të bërë nga qeveria e çdo shteti pjesëmarrës në këtë Marrëveshje përderisa do të konsiderohet që pasojat e këtij kontestimi të mos dëmtojnë interesat e Agjencisë.

Seksioni 8. Asetet e Agjencisë, të ardhurat dhe pasuritë e ndryshme do të përjashtohen:

a) Nga të gjitha taksat direkte, megjithatë është e kuptueshme që Agjencia nuk do të kërkojë të përjashtohet nga taksat që janë në fakt asgjë më shumë se pagesa për shërbime të dobishme publike.

b) Nga detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin duke iu referuar artikujve të importuar ose të eksportuar nga Agjencia për qëllimet e saj zyrtare, e megjithatë është e kuptueshme që artikujt e importuar nën këto përjashtime nuk do të shiten në vendin nga i cili ato janë importuar me përjashtim të arritjes së Marrëveshjeve me qeverinë e këtij vendi.

c) Nga detyrimet, ndalimet dhe kufizimet për importin dhe eksportin lidhur me botimet e saj.

Seksioni 9. Ndërkohë që Agjencia, si rregull i përgjithshëm, nuk do të kërkojë të përjashtohen nga detyrimet e akcizës dhe nga taksat për shitjen e pasurive të tundshme dhe të patundshme, që bëjnë pjesë në çmimin e pagesës, kur Agjencia bën blerje të rëndësishme për qëllime zyrtare të pasurive në të cilat detyrime dhe taksa të tilla i ngarkohen ose janë të ngarkueshme. Shtetet pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje do të bëjnë, kur është e mundur, rregullime të përshtatshme administrative për heqjen ose kthimin e shumave të detyrimeve ose taksave.

Neni 4

Lehtësirat për komunikim

Seksioni 10. Agjencia do të gëzojë, në territorin e çdo shteti pjesëmarrës në këtë Marrëveshje dhe me sa mund të jetë në përputhje me çdo konventë ndërkombëtare, rregullore ose marrëveshje në të cilat ky shtet është pjesëmarrës, për komunikimet e veta zyrtare, trajtime jo më pak të favorshme nga ato që i janë akorduar nga qeveria e këtij shteti çdo qeverie tjetër, përfshirë misionet e sapo emëruara diplomatike, lidhur me prioritetet, pagesat dhe taksat për postat dhe telekomunikacionet dhe pagesat

për informacione që i jepen shtypit dhe radios.

Seksioni 11. Asnjë lloj censure nuk do të zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare dhe komunikimeve të tjera zyrtare të Agjencisë.

Agjencia do të ketë të drejtën të përdorë kodet, të dërgojë dhe të marrë korrespondencën dhe komunikimet e tjera zyrtare nëpërmjet korrierëve ose në çanta të vulosura, të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje sikurse korrierët dhe çantat diplomatike.

Asgjë në këtë seksion nuk do të interpretohet si shmangie ndaj ndalimit të adaptimit të masave siguruese të përshtatshme që do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet shtetit pjesëmarrës në këtë Marrëveshje dhe Agjencisë.

Neni 5

Përfaqësuesit e shteteve

Seksioni 12. Përfaqësuesit e shteteve në takimet e thirrura nga Agjencia, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gjatë udhëtimit të tyre për dhe nga vendi i takimit, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet ndaj ndalimit ose pengimit të tyre dhe ndaj mbajtjes së bagazheve të tyre personale, ndaj fjalëve të folura ose të shkruara dhe të gjitha veprimeve të kryera prej tyre në pozitën e tyre zyrtare, imunitet ndaj procesit ligjor dhe të çdo lloji;

b) mosdhunim të të gjitha letrave dhe dokumenteve;

c) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë letra ose korrespondencë me korrierë ose me çanta të vulosura;

d) përjashtimin për veten e tyre dhe për bashkëshortët nga kufizimet e emigracionit, nga regjistrimi i të huajve ose detyrimet e shërbimit kombëtar në shtetin që ata vizitojnë ose nëpër të cilin ata janë duke kaluar për kryerjen e funksioneve të tyre;

e) të njëjtat lehtësira ndaj valutave ose kufizimeve të shkëmbimeve, ashtu sikurse është rënë dakord për përfaqësuesit e qeverive të huaja me mision zyrtar të përkohshëm;

f) të njëjtat imunitete dhe lehtësira ndaj bagazheve të tyre personale sikurse janë akorduar ndaj anëtarëve të misioneve diplomatike të rangjeve të krahasueshme.

Seksioni 13. Me qëllim që të sigurojë për përfaqësuesit ose anëtarët e Agjencisë liri të plotë të folurit dhe pavarësi të plotë në kryerjen e detyrave të tyre, në takimet e thirrura nga Agjencia, imuniteti nga proceset ligjore ndaj fjalëve të folura ose të shkruara dhe të gjitha akteve të bëra nga ata gjatë kryerjes së funksioneve të tyre do të vazhdojnë t'u akordohen, edhe kur personat përkatës nuk janë më të angazhuar në kryerjen e detyrave të tilla.

Seksioni 14. Kur shkalla e çdo forme të taksimit varet nga qëndrimi, perioda gjatë së cilës përfaqësuesit e anëtarëve të Agjencisë në takimet e thirrura nga Agjencia janë të pranishëm në një shtet anëtar për kryerjen e detyrave të tyre, nuk do të konsiderohet si periode qëndrimi.

Seksioni 15. Privilegjet dhe imunitetet u akordohen përfaqësuesve të anëtarëve, jo për përfitime personale të vetë individëve, por me qëllim që të mbrohet pavarësia e kryerjes së funksioneve të tyre në lidhje me Agjencinë. Rrjedhimisht, një anëtar ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrën që t'u heqë imunitetin përfaqësuesve në çdo rast, ku sipas mendimit të anëtarit, imuniteti do të pengojë punën e drejtësisë dhe ku ai mund të hiqet pa paragjykim ndaj qëllimit për të cilin imuniteti është akorduar.

Seksioni 16. Lehtësirat e seksioneve 12,13 dhe 14 nuk janë të zbatueshme në lidhje me autoritetet e një shteti për të cilin personi është nënshkruar ose për të cilin ai është, ose ka qenë përfaqësues.

Neni 6

Zyrtarët

Seksioni 17. Agjencia kohë pas kohe do t'u bëjë të njohur qeverive të të gjitha shteteve pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje emrat e zyrtarëve për të cilët lehtësirat e këtij neni dhe të nenit 9 do të zbatohen.

Seksioni 18.

a) Zyrtarët e Agjencisë:

i) do të janë të imunizuar nga proceset ligjore ndaj fjalëve të folura ose të shkruara dhe të gjitha akteve të kryera nga ata në kompetencat e tyre zyrtare;

ii) do të gëzojnë të njëjtin përjashtim nga taksat ndaj rrogave dhe shumave të të hollave të paguara atyre nga Agjencia dhe me të njëjtat kushte që gëzojnë zyrtarët e Kombeve të Bashkuara;

iii) do të jenë të imunizuar, së bashku me bashkëshortët dhe të afërmit që varen prej tyre, nga kufizimet e emigrimit dhe regjistrimit të të huajve;

iv) do t'u akordohen të njëjtat privilegje ndaj lehtësirave të këmbimit, ashtu sikurse u akordohen zyrtarëve të misioneve diplomatike të rangjeve të krahasueshme;

(v) do t'u jepen, së bashku me bashkëshortët e tyre dhe të afërmit që varen prej tyre, të njëjtat lehtësira të riatdhesimit gjatë krizave ndërkombëtare, sikurse zyrtarëve të misioneve diplomatike të rangjeve të krahasueshme;

vi) do të kenë të drejtë të importojnë pa detyrime doganore mobiljet dhe pajisje të tjera në kohën e marrjes së postit të tyre për herë të parë në vendin në fjalë.

b) Zyrtarët e Agjencisë do të gëzojnë të gjitha privilegjet shitesë dhe imunitetet e vendosura në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje ndërkohë që kryejnë funksionet e një inspektori sipas nenit 12 të statutit të Agjencisë ose atë të një ekzaminuesi projekti sipas nenit 11 dhe ndërkohë që udhëtojnë në pozitën e tyre zyrtare për ose nga kryerja e këtyre funksioneve, aq sa është e nevojshme për kryerjen efektive të këtyre funksioneve.

Seksioni 19. Zyrtarët e Agjencisë do të përjashtohen nga detyrimet e shërbimeve kombëtare, duke siguruar që në lidhje me shtetin që ata janë nënshtetas, përjashtime të tilla do të kufizohen për zyrtarët e Agjencisë emrat e të cilëve për arsye të detyrave të tyre janë vënë në një listë të hartuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë dhe miratuar nga shteti përkatës.

Nëse zyrtarë të tjerë të Agjencisë do të thirren për shërbime kombëtare, shteti përkatës me kërkesën e Agjencisë do të sigurojë shtyrjen e përkohshme të thirrjes së këtyre zyrtarëve, aq sa është e nevojshme për shmangien e ndërprerjes në vazhdimin e punës themelore.

Seksioni 20. Krahas privilegjeve dhe imuniteteve të përcaktuara në seksionet e mësipërme 18 dhe 19, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, duke përfshirë çdo zyrtar që vepron në emër të tij gjatë mungesës së tij nga detyra, do t'i akordohet në emër të tij, të bashkëshortes dhe fëmijëve të vegjël, privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që u akordohen të dërguarve diplomatik në emër të tyre, të bashkëshortëve të tyre dhe të fëmijëve të vegjël në përputhje me ligjet ndërkombëtare. Të njëjtat privilegje dhe imunitete, përjashtime dhe lehtësira do t'i akordohen Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë ose zyrtarëve të rangjeve ekuivalente të Agjencisë.

Seksioni 21. Privilegjet dhe imunitetet u jepen zyrtarëve vetëm në interes të Agjencisë dhe jo për përfitime personale të vetë atyre. Agjencia do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit të çdo zyrtari në çdo rast ku, sipas mendimit të saj, imuniteti do të mund të pengojë veprimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim në interes të Agjencisë.

Seksioni 22. Agjencia do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet e përshtatshme të shteteve anëtarë për të lehtësuar administrimin e drejtësisë, të sigurojë respektimin e rregullave të policisë dhe të shmangë ndodhjen e çdo abuzimi në lidhje me privilegjet, imunitetet dhe lehtësirat e përmendura në këtë nen.

Neni 7

Ekspertët me mision për Agjencinë

Seksioni 23. Ekspertët (veç zyrtarëve që vijnë në kuadrin e nenit 6) që shërbejnë në komitetet e Agjencisë për kryerjen e misioneve të Agjencisë, duke përfshirë misionet dhe inspektimet në kuadrin e nenit 12 të statutit të Agjencisë dhe si ekzaminues të projekteve sipas nenit 11, do t'u akordohen privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme me aq sa është e nevojshme për kryerjen efektive të funksioneve të tyre, duke përfshirë kohën e shpenzuar për udhëtime në lidhje me shërbimin në këto komitete ose misione:

a) imunitet ndaj ndalimit ose ndjekjes personale dhe ndaj sekuestrimit të bagazheve të tyre personale;

b) në lidhje me fjalët e shkruara ose të folura, ose veprimeve të bëra nga ato gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare, imunitet ndaj proceseve ligjore të çdo lloji, dhe ky imunitet do të vazhdojë edhe kur personat në fjalë nuk do të jenë më në shërbim të komiteteve ose si të punësuar në misionet

për Agjencinë;

c) padhunueshmërinë për të gjitha letrat dhe dokumentet;

d) për qëllimet e komunikimit të tyre me Agjencinë, të drejtën për të përdorur kodet dhe për të marrë letrat ose korrespondencën nga korrierët ose në çantat e vulosura;

e) të njëjtat lehtësira në lidhje me valutat dhe kufizimet e këmbimit sikurse u janë akorduar përfaqësuesve të qeverive të huaja me mision zyrtar të përkohshëm;

f) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tyre personale sikurse u janë akorduar anëtarëve të misionëve diplomatike të rangjeve të krahasueshme.

Seksioni 24. Asgjë në nënparagrafët (c) dhe (d) të seksionit 23 nuk do të interpretohet si shmangie nga adaptimi i masave të përshtatshme të sigurisë që do të përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet një shteti pjesëmarrës në këtë Marrëveshje dhe Agjencisë.

Seksioni 25. Privilegjet dhe imunitetet u jepen ekspertëve të Agjencisë në interes të Agjencisë dhe jo përfitime personale të vetë atyre. Agjencia do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit të çdo eksperti në çdo rast ku, sipas mendimit të saj, imuniteti do të mund të pengojë veprimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim në interes të Agjencisë.

Neni 8

Abuzimi me privilegjet

Seksioni 26. Nëse çdo shtet pjesëmarrës në këtë Marrëveshje konsideron se ka pasur abuzime të një privilegji ose imuniteti të dhënë nga kjo Marrëveshje, do të bëhen këshillime ndërmjet këtij shteti dhe Agjencisë për të përcaktuar nëse një abuzim i tillë ka ndodhur dhe nëse është kështu, të bëhen përpjekje për t'u siguruar se përsëritje të tilla nuk do të ndodhin. Nëse këto këshillime dështojnë, për arritjen e një rezultati të kënaqshëm ndërmjet shtetit dhe Agjencisë, çështja, nëse abuzimi i privilegjit ose imunitetit ka ndodhur, do të zgjidhet me një procedurë në përputhje me seksionin 34. Nëse gjendet që një abuzim i tillë ka ndodhur, shteti pjesëmarrës në këtë Marrëveshje, që është ndikuar nga një abuzim i tillë, ka të drejtën, pas njoftimit të Agjencisë, t'i ndërpresë Agjencisë përfitimin e privilegjit dhe imunitetit me të cilin është abuzuar. Megjithatë, ndërprerja e privilegjit ose imunitetit nuk duhet të ndikojë në aktivitetet kryesore të Agjencisë ose të shmangë Agjencinë nga kryerja e funksioneve të saj kryesore.

Seksioni 27. Përfaqësuesit e shteteve në takimet e thirrura nga Agjencia, ndërkohë që kryejnë funksionet e tyre dhe gjatë udhëtimeve të tyre për dhe nga vendi i takimit, dhe zyrtarëve brenda kuptimit të seksionit 1 (v), nuk do t'u kërkohet nga autoritetet lokale të lënë vendin në të cilin ata janë duke kryer funksionet e tyre për llogari të një aktiviteti të kryer prej tyre në pozitën e tyre zyrtare. Megjithatë në rastin e abuzimit të privilegjit të rezidencës të marrë nga një person i tillë për aktivitetet në këto vende, jashtë funksioneve të tij zyrtare, atij mund t'i kërkohet nga qeveria që të lërë vendin duke i siguruar që:

a) Përfaqësuesve të anëtarëve ose personave që u është dhënë imuniteti i siguruar në seksionin 20, nuk do t'u kërkohet të lënë vendin, veçse në përputhje me procedurat diplomatike të zbatueshme ndaj të dërguarve diplomatikë të akredituar në këtë vend.

b) Në rastin e një zyrtari ndaj të cilit seksioni 20 nuk është i zbatueshëm, nga autoritetet lokale nuk do të nxirret asnjë urdhër për lënien e vendit, përveç atyre që kanë miratimin e Ministrit të Jashtëm të vendit në fjalë, dhe ky miratim duhet të jepet vetëm pas këshillimeve me Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë, dhe nëse ndërmerren procedimet e përjashtimit ndaj një zyrtari, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë ka të drejtë të dalë në këto procedime në emër të personit ndaj të cilit ato janë drejtuar.

Neni 9

Lejet e kalimit

Seksioni 28. Zyrtarëve të Agjencisë do t'u sigurohet përdorimi i lejeve të kalimit të Kombeve të Bashkuara në përputhje me rregullimet administrative të përfunduara ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të njoftojë çdo shtet pjesëmarrës për këtë Marrëveshje dhe për rregullimet

administrative tashmë të përfunduara.

Seksioni 29. Shtetet pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje do të njohin dhe pranojnë lejet e kalimit të Kombeve të Bashkuara që u lëshohen zyrtarëve të Agjencisë, si dokumente të vlefshme udhëtimi.

Seksioni 30. Kërkesat për viza, kur është e nevojshme, nga zyrtarët e Agjencisë që mbajnë lejet e kalimit të Kombeve të Bashkuara, kur shoqërohet me vërtetim që ata janë duke udhëtuar për çështje të Agjencisë, do të trajtohen me shpejtësinë maksimale të mundshme. Për më tepër, këtyre personave do t'u jepen të gjitha lehtësitë për një udhëtim të shpejtë.

Seksioni 31. Lehtësira të ngjashme me ato të specifikuara në seksionin 30 do t'u akordohen ekspertëve dhe personave të tjerë, të cilët ndonëse nuk mbajnë lejet e kalimit të Kombeve të Bashkuara kanë një vërtetim që ata janë duke udhëtuar për çështje të Agjencisë.

Seksioni 32. Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të një rangu jo më të ulët se Kryetari i Sektorit të Agjencisë, që udhëtojnë me lejkalimi të Kombeve të Bashkuara për çështje të Agjencisë, do t'u jepen të njëjtat lehtësira për udhëtim sikurse u janë akorduar zyrtarëve të një rangu të krahasueshëm në misionet diplomatike.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 33. Agjencia do të hartojë kushtet për mënyrat e zgjidhjes së:

a) Mosmarrëveshjeve që lindin jashtë kontratave ose mosmarrëveshjeve të tjera me karakter privat në të cilat Agjencia është Palë.

b) Mosmarrëveshjet që përfshijnë çdo zyrtar ose ekspert të Agjencisë, i cili për arsye të pozitës së tij zyrtare gëzon imunitet, nëse imuniteti nuk është i hequr në përputhje me seksionet 21 ose 25.

Seksioni 34. Përderisa nuk është arritur që për çdo rast Palët të kenë rënë dakord për të pasur rekurse ndaj një mënyre tjetër të zgjidhjes, të gjitha ndryshimet që lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i referohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me statutin e kësaj Gjykate. Nëse një ndryshim lind ndërmjet Agjencisë dhe një anëtar dhe ata nuk bien dakord për ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes, bëhet një kërkesë për një opinion këshillues për çdo çështje legale të përfshirë, në përputhje me nenin 96 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe nenit 65 të statutit të Gjykatës dhe të kushteve përkatëse të Marrëveshjes të përfunduar ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Agjencisë. Opinioni i dhënë nga Gjykata do të pranohet si përfundimtar nga Palët.

Neni 11

Interpretimet

Seksioni 35. Kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen në dritën e funksioneve me të cilat Agjencia është ngarkuar nga statuti i saj.

Seksioni 36. Kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të kufizojnë në asnjë mënyrë ose të paragjykojnë privilegjet dhe imunitetet, të cilat i kanë qenë akorduar ose mund t'i akordohen më vonë Agjencisë nga çdo shtet për arsye të vendosjes në territorin e këtij shteti të Shtabit të Agjencisë ose zyrave rajonale, ose të zyrtarëve, ekspertëve, materialeve, pajisjeve ose sendeve të tjera në lidhje me projektet ose aktivitetet e Agjencisë, duke përfshirë zbatimin e garancive ndaj një projekti të Agjencisë ose rregullimeve të tjera. Kjo Marrëveshje nuk do të shërbejë për shmangien e përfundimit ndërmjet Agjencisë dhe çdo shteti pjesëmarrës të marrëveshjeve plotësuese që përmirësojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje ose shtrijnë ose shkurtojnë privilegjet dhe imunitetet e dhëna.

Seksioni 37. Kjo Marrëveshje nuk do të veprojë në vetvete në mënyrë që të abrogojë, ose të devijojë nga kushtet e Statutit të Agjencisë ose çdo e drejtë ose detyrim të cilin Agjencia mund ta ketë, ta kërkojë ose ta konsiderojë të mirëqenë.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

Seksioni 38. Kjo Marrëveshje do t'i komunikohet çdo shteti anëtar të Agjencisë për pranim. Pranimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit tek Drejtori i Përgjithshëm i një instrumenti pranimi dhe

Marrëveshja hyn në fuqi për çdo anëtar në përputhje me datën e depozitimit të instrumentit të pranimi të anëtarit. Kuptohet që kur një instrument pranimi depozitohet në emër të çdo shteti, ky shtet do të jetë në një pozitë në përputhje me ligjet e tij për t'i bërë efektive kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm do t'i japë një kopje të vërtetuar të kësaj Marrëveshjeje qeverive të çdo shteti që është ose do të bëhet anëtar i Agjencisë, dhe do të informojë të gjithë anëtarët për depozitimin e çdo instrumenti pranimi dhe për dërgimin e çdo informacioni për denoncim të parashikuar për të në seksionin 39.

Është e lejueshme për çdo anëtar që të ketë rezerva ndaj kësaj Marrëveshjeje. Çdo rezervë mund të bëhet vetëm në kohën e depozitimit të instrumentit të pranimi, dhe do t'u komunikohet menjëherë nga Drejtori i Përgjithshëm të gjithë anëtarëve të Agjencisë.

Seksioni 39. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të jetë në fuqi ndërmjet Agjencisë dhe çdo anëtar që ka depozituar një instrument pranimi përsa kohë që ky anëtar mbetet një anëtar i Agjencisë, ose përderisa një Marrëveshje e rishikuar është miratuar nga Bordi i Governorëve dhe ky anëtar është bërë Palë e kësaj Marrëveshjeje të rishikuar, duke siguruar që, nëse një anëtar bën në njoftim ose denoncim tek Drejtori i Përgjithshëm, kjo Marrëveshje bie nga fuqia në lidhje me këtë anëtar një vit pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Drejtori i Përgjithshëm.

Seksioni 40. Me kërkesën e një të tretës së shteteve pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje, Bordi i Governorëve të Agjencisë do të marrë në konsideratë nëse një amendament i paraqitur prej tyre duhet miratuar ose jo. Amendamentet e miratuara nga Bordi do të hyjnë në fuqi me paraqitjen e tyre në përputhje me procedurën e treguar në seksionin 38.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 19.2.2003
Doli nga shtypi më 20.2.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë